

Pajtimi dhe bashkëpunimi rajonal nga këndi i politikanëve

Analizë e deklaratave të liderëve të vendeve post-jugosllave

Janar- Gusht, 2016.

Hyrje

Kur është fjala për pajtimin dhe bashkëpunimin rajonal në frymën e tejkalimit të pasojave të luftërave dhe të traumave njerëzore në hapësirën e ish Jugosllavisë, analiza e deklaratave të përfaqësuesve më të lartë të institucioneve shtetërore, të publikuara nëpër media në gjashtë muajt e parë të vitit 2016, flet se ata deklarativisht janë të gatshëm për të punuar në frymën e pajtimit dhe të bashkëpunimit, por nuk ka vepra konkrete, të cilat e vërtetojnë këtë. Kështu, mediat në rajon këtë vit kanë qenë plot me shkrime mbi rritjen e animozitetit midis shteteve, në relacionet Kroaci – Serbi – Bosnjë dhe Hercegovinë. Një nga gjeneratorët e kësaj ftohjeje ka qenë qeveria e re e Kroacisë, e formuar qysh në fillim të këtij viti dhe e përbërë nga partitë e së djathtës në krye me HDZ-në. Kjo qeveri nuk ka qenë në mënyrë vendimtare e motivuar me përparimin e bashkëpunimit rajonal, por me konfliktet e brendshme ideologjike dhe me ekskluzivizmin nacional, i cili shpesh është shprehur në „sjelljen arrogante ndaj Serbisë dhe pengimin e negociatave të saj me BE-në“¹. Serbia është përgjigjur me jo më pak retorikë agresive dhe me disa nota proteste drejtuar Zagrebit², dhe, kështu, në muajin gusht të vitit 2016 ka ekzistuar brengosja e arsyetuar se si do të zhvillohen këto marrëdhënie deri në fund të vitit.

Po ashtu, as edhe marrëdhëniet midis Serbisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës nuk kanë shkuar këtë vit në drejtim të bashkëpunimit rajonal: krahas disa takimeve të suksesshme rajonale dhe konferencave të nivelit evropian, ka pasur tensione lidhur me atë nëse kreu shtetëror i Serbisë është i mirëseardhur në komemoracionin e viktimave në Srebrenicë ose jo³, nëse vizita e anëtarit të Presidencës së B dhe H, Bakir Izetbegovićit në Sanxhak është “skandal diplomatik” ose jo⁴, si dhe nëse B dhe H prapë do të ngrit padi për gjenocid kundër Serbisë pas aktgjyqimit të Radovan Karaxhiqit në Hagë. Kësaj do shtuar tensionet në B dhe H në relacionet Federata – Republika Srpska, si dhe tensionet rreth statusit shtetëror të Malit të Zi, marrëdhëniet e brendshme të malazezve dhe serbëve si dhe dëshirën e qeverisë malazeze për anëtarësim në Aleancën e NATO-s.

Po ashtu, marrëdhëniet në relacionet Beograd – Prishtinë me vite janë të tendosura dhe të pasigurta, kurse marrëdhëniet e brendshme në Maqedoni, ato politike dhe etnike, shpesh janë

¹ Seebiz, 27. 7. 2016. „Millanović: HDZ, në pikëpamjen lidhur me Serbinë sillet në mënyrë papnore (Milanović: HDZ se u pogledu Srbije ponaša papački“)

² Dnevnik.hr, 1. 8. 2016. „Serbia: “Kroacia duhet të distancohet nga lavdërimi i terroristëve dhe i vrasësve” (Srbija: Hrvatska se treba ograditi od veličanja teroriste i ubojice“)

³ Dnevni Avaz, 27. 6. 2016. “VUČIĆI MBI SREBRENICËN: E pranojmë se jemi tepër!” (VUČIĆI O SREBRENICI: Prihvatamo da smo višak!“)

⁴ Politika, 29. 7. 2016. Izetbegović i ka barazuar Sanxhakun dhe Republika Srpska” („Izetbegović izjednačio Sandžak i Republiku Srpsku“).

ashpërsuar deri në pikën e konfliktit të dhunshëm. Në mënyrë përfundimtare, kur është fjala për rajonin në tërësi, kemi të bëjmë me një proces kompleks, i cili, nga njëra anë, lëviz drejt pajtimit dhe bashkëpunimit, kurse, në anën tjetër, është plot me tensione të vjetra, të cilat shfaqen në mënyrë sporadike dhe procesin e pajtimit deri diku e vështirësojnë dhe e ngadalësojnë.

Kroacia

Grupimi i partive të djathta, i ashtuquajtur i koalicioni patriotik, i cili ka ardhur në pushtet pas zgjedhjeve parlamentare në muajin nëntor të vitit 2015, ka hasur, krahas përkrahjes masive të trupit zgjedhor djathtist, edhe në rezistencën proporcionalisht po aq të fortë të opinionit publik intelektual. Ky publik me orientim të majtë politik e ka përpiluar në fillim të muajit shkurt peticionin me emrin *Kulturalistët 2016*⁵ (*Kulturnjaci*) për heqje të ministrit të kulturës në mënyrë të skajshme me orientim të djathtë Zlatko Hasanbegovićit dhe të vendimeve të tij represive kundër atyre që nuk mendojnë si ai si dhe kundër institucioneve me orientim liberal. Nismën, deri në fund të muajit gusht e kanë nënshkruar rreth pesë mijë njerëz⁶, jo vetëm nga Kroacia, por edhe nga rajoni dhe Evropa. Qëndrimi i tyre se kjo „është përkrahje e idesë së kulturës të ruajtur nga lajthitjet ideologjike, konzervativizmi, nacionalizma, ekskluziviteti dhe tradicionalizmi fisnor“⁷, e vendos këtë grup fuqishëm në anën e idesë së pajtimit dhe të bashkëpunimit. Liderët politik të opozitës së majtë politike nuk janë deklaruar lidhur me këtë nismë, pos ish-ministres së kulturës Andree Zlatar Violiq⁸, të cilës i janë bashkuar edhe një numër i madhe i personave publik. Kjo opozitë e dukshme kulturore, duke iu kundërvënë, për shembull, ndalimit të modernizimit dhe reformës së shkollimit, të cilën e ka inicuar pushteti i ri konservator, ia ka dalë që në fillim të muajit qershor, me anë të parullës “Kroacia mundet më mirë” për të nxjerrë rreth 25 000 qytetarë në sheshet e qyteteve të mëdha në Kroaci.⁹ Shenjat e para të ngadalësimit të bashkëpunimit rajonal kanë qenë të dukshme në deklaratat e kreut politik të Kroacisë mbi përdorimin e termeve të deritashme të përbashkëta. Kështu, presidentja kroate Kolinda Grabar Kitarović i ka lutur bashkëpunëtorët e saj „që në dokumentet zyrtare të mos e përdorin termin e rajonit“¹⁰, derisa ministri i punëve të jashtme Miro Kovač iu ka urdhëruar vartësve të tij që „ai term i paqartë i rajonit“¹¹ të zëvendësohet me termin “fqinjësi”, sepse ky është “term më i saktë”.

Datën e festimit të aksionit ushtarak “Oluja” ((Stuhia) të vitit 1995, kur çdo të pestin gusht testohen deklaratat e politikanëve në kontekst të gatishmërisë për pajtim dhe bashkëpunim rajonal, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut e ka shfrytëzuar për të përpiluar peticionin publik me të cilin ka kërkuar që krahas aksionit ushtarak “Oluja”, publikut t’i përkujtohen edhe

⁵ Nacional, 4. 2. 2016.: “Nisma kulturalistët 2016: Apel publik për largimin e Zlatko Hasanbegovićit” („INICIJATIVA KULTURNJACI 2016: Javni apel za smjenu Zlatka Hasanbegovića“).

⁶ <http://www.kulturnjaci2016.org/>

⁷ Ibid.

⁸ Novosti, 19. 6. 2016. “Andrea Zlatar Violiq: Hasanbegović do të thotë neoustashizim i shoqërisë” („Andrea Zlatar Violić: Hasanbegović znači neustažizaciju društva“).

⁹ 1. 6. 2016. HRT, “25 mijë qytetarë e kanë mbështetur reformën kurikulare” („25 tisuća građana poduprlo kurikulumu reformu“).

¹⁰ Novine.net, 19. 2. 2016. “Grabar Kitarović: Çka është “ai farë rajoni?” („Grabar Kitarović: Što ‘‘je to regija?“).

¹¹ Telegram, 30. 1. 2016. “Urdhri kontraverz i shefit të ri të diplomacisë: Rajoni ose fqinjësia?” („Kontroverzni naputak novog šefa diplomacije: Regija ili susjedstvo?“)

viktimat civile të ushtrisë kroate në këtë aksion. Shumë media e kanë transmetuar shpalljen e Nismës së të Rinjve me titullin „Interesi nacional është pranim dhe jo gënjeshtëri”¹², por edhe atë se “peticioni ka hasur në publik në reaksione të ndryshme negative të personave, të cilët e konsiderojnë provokim”¹³, dhe se, së këndejmi, e kanë nënshkruar „diçka më shumë se sa 300 njerëz.”¹⁴ Grupimi tjetër i aktivistëve paqësor ka demonstruar dy ditë para festimit në Knin, në sheshin kryesor të Zagrebit, duke kërkuar që festimi i aksionit ushtarak “Oluja” të mos mbahet fare.¹⁵ Duke e bërë një transparent të madh „Oluja – krimi i cili ende vazhdon“, një numër i vogël i aktivistëve kanë qenë në rrezik që të jenë fizikisht të sulmuar nga turma e tërbuar nacionaliste, të cilën e ka parandaluar kordoni i fortë i policisë dhe të cilën e kanë regjistruar të gjitha mediat elektronike dhe të shkruara.¹⁶ Në lidhje me kërkesën e Nismës së të Rinjve për kërkimfalje ndaj viktimave civile të aksionit ushtarak 'Oluja', duhet të thuhet se asnjë politikan në Kroaci nuk është deklaruar si dhe do theksuar faktin se tubimi protestues në Sheshin e Bane Jelaçiqit kundër festimit të aksionit ushtarak “Oluja” ka qenë i ndaluar.¹⁷ Nuk ka pasur as deklarata kuortazije të politikanëve lidhur me këtë viktimita a aksionit ushtarak “Oluja” si edhe vitet e mëparshme. Ky fenomen i thellë i “heshtjes së qetë të shumicës kroate” është shpjeguar mirë nga prof. Zharko Puhovski në një intervistë të tij dhënë radios *Deutsche Welle*, duke theksuar se në hapësirën e Kroacisë është fjala për fenomenin historik të së ashtuquajturës shumicës “patriotike” ose mikroborgjeze. Kur është fjala për kombin, shumica e tillë në mënyrë kronike është e gatshme që këtë pakicë proustashe ta shoh nëpër gishta, sepse këta, prapëseprapë, siç e thotë Puhovski, janë “djelmohat tanë” ... „Në parim, edhe në shtetet e tjera evropiane ekzistojnë tre deri në pesë për qind e popullatës, e cila e mbron një opsion të tillë radikal, por problemi është se ajo në Kroaci shumë në mënyrë më të thjeshtë dhe zemërhapur tolerohet se sa në vendet të cilat kanë një kulturë politike dukshëm më të zhvilluar“, thotë Puhovski.¹⁸ Komentet nën tekstet në botimet on-line të gazetave ose portalet elektronike, të lidhura me çështjet e pakicave, të përfaqësuesve të tyre, me tolerancë, me festimin e aksionit ushtarak “Oluja” dhe ngjashëm – kjo duhet të theksohet - kanë qenë me bollëk sipas rregullës në humnerat e një fjalori skajshmërisht të shëmtuar dhe të urrejtjes nacionaliste, gjë që në tetë muajt e parë të vitit 2016 i ka marrë përmasat e pothuajse histerisë masive.

Shikuar nga këndvështrimi kronologjik, sipas shkrimeve të mediave, viti 2016 ka filluar qetë dhe në tonin e durueshmërisë dhe të tolerancës: presidentja e Kroacisë Kolinda Grabar Kitarović ka qenë e pranishme në festimin e Pashkëve Ortodoks në Kishën e Katedrales së Transformimit të

¹² Jutarnji list, 29. 7. 2016. “KUSH ËSHTË JUMBO I PLLAKATIT? Nisma e të rinjve kërkon kërkimfaljen e Kroacisë për viktimat a aksionit ushtarak “Oluja” („TKO JE IZA JUMBO PLAKATA? Inicijativa mladih traži ispriku Hrvatske žrtvama Oluje“)

¹³ Po aty.

¹⁴ Novosti, 3. 8. 2016. “Na falni!” („Oprostite!“)

¹⁵ Dnevno.hr, 2. 8. 2016. “Kush ka lejuar që kjo të ndodh?!” („TKO JE TO DOPUSTIO?!“)

¹⁶ N1, 4. 8. “Mbrotësit e demonstrantëve: “Çetnikët! Marshi nga Kroacia” (Branitelj demonstrantima: “Četnici! Marš iz Hrvatske!“).

¹⁷ Direktno. hr, 3. 8. “Orepiqi e ka ndaluar protestën kundër aksionit ushtarak “Oluja” në Sheshin e Bane Jelaçiqit!” („Orepić zabranio prosvjed protiv Oluje na Trgu bana Jelačića!“)

¹⁸ Deutsche Welle, 5. 8. 2016. “Gënjejnë edhe në anën serbe e edhe në atë kroate” (“Lažu i na srpskoj i na hrvatskoj strani“).

Zotit në Zagreb kur në deklaratën për gazetarë e ka theksuar se si të gjithëve iu dëshiron Pashkë të lumtura dhe të bekuara dhe krahas përshëndetjes „Paqja e Zotit, Krishti ka lindur!“, iu ka dëshiruar të gjithë qytetareve dhe qytetarëve paqe dhe mirësi si dhe përparim në vitin 2016. Mitropoliti Porfirije Periq ka theksuar se ato fjalë asnjëherë nuk kanë qenë aq të nevojshme sa sot.¹⁹ Qysh në muajin shkurt, pas demonstratave të nacionalizmit dhe të shovinizmit të asaj pjese të publikut i cili e mbështet pushtetin konservativ, kryetari i bashkësisë serbe në Kroaci, Millorad Pupovac, i ka shkruar letër presidentes Kitaroviq duke ia tërhequr vërejtjen lidhur me „rritjen e porosive për urrejtjen ndaj pakicave politike, etnike dhe të tjerave në Kroaci,“²⁰ duke cekur një varg të gjatë të personave publik, të cilët i janë ekspozuar linçimit publik. Presidentja i është përgjigjur me një ton formal të „mirëkuptimit dhe të dënimit të veprave të tilla“, duke mos e lënë pa thënë se si në mesin e personave të sulmuar „ka edhe të tillë, të cilët me veprimtarinë e tyre publike me vite provokojnë, irritojnë e, madje, edhe fyejnë pjesën më të madhe të publikut kroat, se e paraqesin në mënyrë të rrejshme e madje edhe e tallin luftën atdhetare dhe, në thelb, e mohojnë realitetin dhe, në mënyrë implicite edhe vet idenë e shtetit kroat ...“²¹

Nga mesi i muajit prill është vazhduar prapë me ton korrekt: presidentja Grabar-Kitaroviq dhe kryeministri i Serbisë Aleksandar Vuçiqi janë takuar në Panairin Ndërkombëtar të ekonomisë në Mostar, kur kanë biseduar mbi marrëdhëniet bilaterale të dy shteteve. „Mendoj se vitet fundit kemi pasur vështirësi, të cilat ia vlen për t’i tejkaluar. Kemi pasur zgjedhje dhe retorika ka qenë pak më e fortë. Nuk do të thosha se marrëdhëniet janë të tendosura. Ekziston përleshja retorike. Thelbësor është mirëkuptimi dhe të dihet se si të rregullohet vendi që për popullin shumicë, por edhe për pakicat, që të ndjehen të sigurt. Shpresoj se do t’i qetësojmë tensionet ...“, ka thënë Grabar Kitaroviq.²²

Në fund të muajit maj në Sarajevë janë takuar kryetarët e tetë shteteve të Evropës Juglindore në samitin vjetor 'Brdo-Brionet', në të cilin presidentja kroate ka thënë se si në rajon „ende mungon optimizmi“ si dhe se „në frymën e bashkëpunimit dhe të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë të vazhdojmë të punojmë në mbështetjen dhe në politikën e zgjerimit“. Në samit, kryetarët e vendeve të rajonit e kanë nënshkruar deklaratën, me të cilën janë obliguat për dialogun reciprok, mirëkuptimin dhe besimin si dhe përkushtimin për bashkëpunimin në tejkalimin e sfidave, të

¹⁹ Novi list, 6. 1. 2016.

²⁰ RTL, 13. 2. 2016. „Pupovci i shkruan Kolindës: “Më pështyjnë dhe bërtasin – çetnikë, shko në Serbi” (Pupovac pisao Kolindi: 'Pljuju me i viču - četniče, idi u Srbiju').

²¹ Jutarnji list, 13. 2. 2016. „PRESIDENTJA I THOTË PUPOVCIT“ Po, është rritur mosdurimi, por para ardhjes së qeverisë së re. Ish kryeministri ka thënë “ose ne ose ata”, kurse në gazetën Novosti është tallur me himnin kroat “(PREDSJEDNICA PUPOVCU 'Da, porasla je nesnošljivost, ali prije dolaska nove Vlade. Bivši premijer je rekao 'ili mi ili oni', a u Novostima se izrugivalo s hrv. himnom“).

²² Dnevno.hr, 12. 4. 2016. “NË RESTORANTIN ROMANCA, VUČIQI DHE KOLINDA GRAVBAR KITAROVIQ JANË TAKUAR VETËM” („U RESTORANU ROMANCA VUČIĆ I KOLINDA GRABAR KITAROVIĆ SASTALI SE NASAMO“).

cilat i kërcënohen rajonit si dhe në shmangien e armiqësive të shekullit të kaluar dhe mbështetjen reciproke në procesin e integriteteve evropiane.²³

Është karakteristike se si *Delo* e Lubjanës ka raportuar me skepsë nga takimi: „Nuk ka kurrfarë sigurie se konfliktet në Maqedoni, në Mal të Zi, në B dhe H dhe në Kosovë do të zgjidhen me anë të dialogut politik. Normalizimi i marrëdhënieve të Beogradit dhe Prishtinës tash e një kohë është vetëm një shkronjë në letër, Kroacia i vë pengesa Serbisë në rrugën e saj evropiane, kurse është karakteristikë e përbashkët e Ballkanit niveli i ulët i demokracisë“, e thekson gazeta.²⁴

Takim i një rëndësie delikate ka qenë edhe samiti i shefave të shteteve dhe i qeverive “Paris – Ballkan 2016” në Paris (si pjesë e “Procesit të Berlinit” të filluar në vitin 2014), me ceremoninë e nënshkrimit të Deklaratës mbi themelimin e një Zyre Rajonale për bashkëpunimin e të rinjve. Këtë dokument, me themelin e Deklaratës të miratuar në samitin e Vjenës në vitin 2015, e kanë nënshkruar kryeministrat e Shqipërisë, B dhe H, Kosovës Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Përfaqësuesit shtetëror të Kroacisë kanë qenë të pranishëm në takim në formë të vëzhguesve, dhe Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut me atë rast e ka dërguar një deklaratë publike në të cilën thuhet se „pajtimi pa Kroacinë, në kontekstin e hapësirës së ish Jugosllavisë, nuk ka kuptim“.²⁵

Në ton korrekt ka kaluar edhe takimi i presidentes kroate Kitarović dhe kryeministrit Vučić në Dalje, përkatësisht në Suboticë, në gjysmën e dytë të muajit shkurt. Ashtu siç transmeton TV N1, me atë rast Kitarović dhe Vučić e kanë nënshkruar „Deklaratën mbi përparimin e marrëdhënieve dhe zgjidhjen e çështjeve të hapura midis Serbisë dhe Kroacisë“, i kanë vizituar përfaqësuesit e pakicave në të dyja anët e kufirit dhe kanë premtuar se do të punojnë që pozita e tyre të jetë dukshëm më e mirë. Ose, ashtu siç ka thënë presidentja kroate, „kanë qenë këto takime përmbajtësore, të cilat do të rezultojnë me hapa konkret dhe efikas drejt të ardhmes në kuptimin e zgjidhjes së çështjeve, të cilat i ngarkojnë marrëdhëniet tona ndërshtetërore. Kemi dëshiruar që në vendin e ngjarjes të njihemi me problemet dhe me sfidat me të cilat ballafaqohet bashkësia serbe në Kroaci dhe ajo kroate në Serbi.“²⁶ Vetëm 10 ditë më vonë, ka rezultuar deri te një mbyllje e papritur të kufirit kroato-serb tek Batine (në njoftim nga ana kroate thuhet se ka qenë fjala për masat e kontrollit të emigrantëve), për çka kanë raportuar të gjitha mediat kroate dhe rajonale,²⁷ gjë e cila, kjo do të tregohet më vonë, ka qenë një hyrje në muajt turbulent të verës ... Ka filluar me një kontra-miting të pjesëtarëve të së djathtës së skajshme, të cilët kanë dashur për ta penguar shënimin e festës së Kryengritjes së serbëve të datës 27. 07. 1941, dhe me zbulimin e përmendores së Mira Bareshiqit (të dënuar në Suedi në vitin 1971 për vrasjen e ambasadorit

²³ Konkluzionet e takimit të liderëve të procesit Brdo-Brionet, Sarajevë, Bosnja dhe Hercegovina, 28.-29. maj 2016. (Zaključci sastanka lidera Brdo-Brijuni procesa, Sarajevo, Bosna i Hercegovina, 28.-29. maj 2016). <http://www.predsjednistvobih.ba/saop/default.aspx?id=71364&langTag=bs-BA>.

²⁴ HINA, 30. 5. 2016. “Procesi i pajtimit në Ballkan është ngadalësuar, duhet t’i kthehemi ekonomisë” („Proces pomirenja na Balkanu je usporen, treba se okrenuti gospodarstvu“).

²⁵ Novi list, 4. 7. 2016. “RAJON OSE FQINJËSI Samiti në Paris” („REGIJA ILI SUSJEDSTVO Summit u Parizu“).

²⁶ TV N1, 20. 6. 2016.

²⁷ Slobodna Dalmacija, 1. 7. 2016. “Vučić mbylljen e kufirit në Batinë e ka quajtur “lojë në fqinjësi” („Vučić zatvaranje granice na Batini nazvao 'igrarijama u susjedstvu“).

jugosllav Vladimir Roloviqit në Stokholmu), në të cilin janë shfaqur edhe disa anëtarë të qeverisë aktuale, të cilët Bareshiqin e kanë quajtur „hero dhe atdhedashës“.²⁸ Ka vazhduar me aktgjykimet me të cilat lirohen nga përgjegjësia kryepeshkopi Stepinac, i dënuar për bashkëpunimin me regjimin ustash, dhe Branimir Gllavashit, i dënuar për vrasjen e civilëve serb në Osijek në vitin 1991. Kanë qenë këto ngjarjet, të cilat në mënyrë të dukshme i kanë ngritur tensionet ndërnacionale në Kroaci dhe këto aspak nuk i kanë kontribuar atmosferës së pajtimit dhe të bashkëpunimit rajonal, posaçërisht kur është fjala për marrëdhëniet midis Kroacisë dhe Serbisë. Në ceremoninë e shënimit të aksionit ushtarak “Oluja” në Knin, në atmosferën politikisht dhe nacionalist të nxehur, është djegur flamuri serb, është brohoritur përshëndetja ustashe „Për atdheun të gatshëm“ dhe kanë defiluar individ në uniforma të zeza.²⁹ Në ceremoni ka folur edhe presidentja Kitaroviq, e cila, midis të tjerash, ka thënë: „Dëshiroj në mënyrë të qartë për të thënë se e respektoj secilën viktimë, sepse secila jetë njësoj është e vlefshme. “Oluja” ka qenë dhe do të mbetet politikisht e arsyetuar, në plan etik e pastër dhe në mënyrë brilante e realizuar.“ Ajo ka përkujtuar një numër të madh të çështjeve, vrasjet dhe shkatërrimet, të cilat i ka shkaktuar agresioni serbomadhe dhe, përkundër kësaj, „politika e shtetit kroat nuk ka urdhëruar, ndërmarrë dhe as ka miratuar asnjë akt hakmarrës, por ka shprehur gatishmërinë për pajtim dhe për falje.“³⁰

Një ditë më vonë, këtë fjalim e ka komentuar kryetari i Këshillit Popullor Serb Milorad Pupovac, në komemoracionin e viktimave serbe në kohën e aksionit “Oluja” në Gornje Selishte (Gornje Selišta) pranë Glinës: „Dita e djeshme në Knin në shumë prej nesh ka shkaktuar ankth dhe kjo vazhdon edhe sot. Mesazhet, të cilat i kemi dëgjuar, simbolet të cilat i kemi parë dhe veprimet, dëshmitarë të të cilave jemi, janë provë se mbizotëron armiqësia, urrejtja, dhe se është e lirë ajo ideologji dhe ajo lëvizje, që në mënyrë ekskluzive është e ushqyer me urrejtje, me armiqësinë dhe dëshirën për vdekje.“ Gjatë komemoracionit Pupovac ka shprehur respekt për të gjitha viktimat në Kroaci - edhe për kroatët e edhe për serbët, si dhe ka theksuar se si pushteti është përgjegjës për ta luftuar urrejtjen, e cila në shoqëri është e pranishme gjithnjë shumë e më shumë, dhe se ky pushtet duhet të hap mundësinë për pajtim, tolerancë dhe punë të përbashkët për një të ardhme më të mirë.³¹ Një vizioni të tillë të festimit të aksionit ushtarak “Oluja” i është bashkëngjitur edhe udhëheqësja e Dokumente – Qendra për Ballafaqim me të Kaluarën, Vesna Tersheciç, e cila ka porositur se si „është zhgënjyese që në Kroaci në Ditën e Fitores dhe të mirënjohjes atdhetare e festojmë vetëm fitoren, kurse nuk i përkujtojmë viktimat“, duke vënë në spikamë se si „në kuptimin civilizues është me rëndësi që të mbahet mend gjithçka, pa marrë parasysh se në cilën anë janë vrarë“.³²

²⁸ HRT, 1. 8. 2016. "Për shkak të monumentit të Bareshiqit, protestojnë Beogradi dhe Podgorica" („Zbog spomenika Bareshiću prosvjeduju Beograd i Podgorica“).

²⁹ Indeks.hr, 5. 8. 2016. “Turp i ri në Knin: Me taktet e këngës së Thompsonit digjet flamuri serb” („Nova sramota u Kninu: Uz taktove Thompsonove pjesme zapaljena srpska zastava“)

³⁰ 5. 8. Dnevnik.hr “Grabar Kitaroviq i përgjigjet Millanoviqit: Unë dua për t’iu dërguar një mesazh atyre që Kroacinë e kanë quajtur shtet të rastësishëm,” (“Grabar Kitarović prozvala Milanovića: 'Želim poslati poruku onima koji su Hrvatsku nazvali slučajnom državom...“)

³¹ N1 Hr, 6. 8. 2016. “Pupovac: E premtja në Knin shumëkujt i ka shkaktuar ankth” („Pupovac: Petak u Kninu u mnogima je izazvao zebnju“).

³² N1, 3. 8. 2016. „Përse pas përvjetorit të aksionit ushtarak “Stuhia” nuk nderohen viktimat?“ (Zašto nakon obljetnice Oluje nema odavanja počasti žrtvama?“).

Mund të përfundojmë se në tetë muajt e parë deklaratat e udhëheqësve politik dhe shtetëror në Kroaci nuk kanë shkuar gjithherë në drejtim të përmirësimit të bashkëpunimit rajonal dhe pajtimit, por ekzistojnë edhe shpresat reale se pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në muajin shtator, temperatura e ngritur politike deri në fund të vitit mund të bie në nivelin e marrëdhënieve konstruktive rajonale.

Serbia

Kreu shtetëror serb këto vitet e fundit është duke u përpjekur në publik për ta paraqitur politikën e Serbisë ndaj fqinjëve si një synim në një ton konstruktiv, si të hapur nga e ardhmja, lidhjet e ekonomike dhe marrëdhëniet korrekte ndërfaqinësore. Teorikja Vesna Rakiq Vodineliq strategjinë e tillë qysh para dy vitesh e ka shpjeguar me togfjalëshin „nuk është e thënë që të ketë shumë dashuri, e rëndësishme është që të respektohem”³³, përkatësisht se, siç është thënë në mesin e muajit gusht në Fondin Ballkanik për Demokraci, „Mospërgjigjja e Serbisë ndaj provokimeve të ndryshme në dy vitet paraprake e ka vërtetuar vullnetin e saj për ta ruajtur paqen në rajon dhe që të jetë bashkëpjesëmarrës në paqe.”³⁴ Në të njëjtën kohë, përfaqësuesit e lartë të Serbisë, duke reaguar ndaj potezave të caktuar nga fqinjësia, që iu janë dukur fyes ndaj Serbisë ose diskriminuese ndaj pakicës serbe në ato vende, kryesisht janë shërbyer me fjalorin e të ashtuquajturit imperativ të padiskutueshëm moral, duke e theksuar lidhjen tradicionale të Serbisë me idenë e antifashizmit, duke numëruar viktimat e mëdha të Serbisë në të dyja luftërat botërore dhe duke vënë në spikamë persekutimet dhe vuajtjet e serbëve në luftërat e fundit, të cilat në mënyrë dominante kanë qenë rezultat i politikës agresive të fqinjëve. Kështu, kryeministri i qeverisë së Serbisë Aleksandar Vuçiq në samitin pranveror rajonal në Mostar ka deklaruar se bashkëpunimi rajonal është me rëndësi kyçe dhe se do të investohen shumë përpjekje dhe mund që të ruhet paqja dhe qëndrueshmëria për të gjithë njerëzit në Ballkanin Perëndimor. „Boshnjakët duhet të hyjnë në lëkurën serbe, kurse serbët në lëkurën boshnjake në mënyrë që të kuptohen më mirë dhe që bashkërisht të shikojnë drejt të ardhmes. Të gjithë do të përpiqemi që ta lëshojmë tonin dhe që t’i përparojmë marrëdhëniet tona, sepse serbët dhe boshnjakët e kanë të ardhmen e përbashkët. Serbët dhe boshnjakët jetojnë së bashku edhe në Serbi e edhe në B dhe H“, ka thënë Vuçiqi.³⁵ Nga ana tjetër, Në TV debatin në B92, ato ditë për Vuçiqin ka qenë strategjikisht e rëndësishme zgjedhja e drejtësisë për viktimat serbe: „Duhet të respektojmë viktimat tona, kurse nuk po i respektojmë ato. Nuk i dimë emrat e njerëzve, të cilët janë vrarë. Nuk e dimë se krejt kush është vrarë gjatë bombardimeve të NATO-s. Nuk kemi një qëndrim as edhe ndaj viktimave tona, e të mos flasim për viktimat e huaja. Ky është një qëndrim i papërgjegjshëm ndaj të ardhmes.”³⁶ Në këtë këmbim të toneve të nxehta të ftohta, të tolerancës konstruktive me vërejtjet morale, ka folur edhe ministri i rinisë dhe i sportit, Vanja Udoviçiq, në konferencën në Paris në fillim të muajit korrik, në të cilën është prezantuar Zyra Rajonale për të Rinjtë: „Zyra është menduar si një platformë për bashkëpunimin dhe këmbimin e dijeve dhe të përvojave të të rinjve,

³³ Peščanik, 19. 5. 2014. „Vështirësitë e Vuçiqit në Sarajevë” („Prikličenija Vučićeva u Sarajevu“).

³⁴ TANJUG, 17. 8. 2016.

³⁵ Novosti, 12. 4. 2016. Vuçiqi: Bashkëpunimi rajonal është me një rëndësi kyçe” („VUČIĆ: Regionalna saradnja od ključnog značaja“).

³⁶ Alo.rs, 5. 4. 2016. SERBIA DHE RAJONI, Vuçiqi: Nuk i nderojmë viktimat tona e as të huajat” („SRBIJA I REGION Vučić: Ne poštujemo svoje žrtve, pa ni tuđe“).

sepse dëshirojmë t'iu përgjigjemi nevojave të rinjve të këtyre hapësirave dhe që në të njëjtën kohë t'ua japim shansin që të përsosen dhe të përparojnë dhe, me këtë, t'i kontribuojnë zhvillimit të rajonit.³⁷ Po ashtu, me rastin e takimit të kohëve të fundit në Bruksel, kryeministri serb Vuçiq është lavdëruar nga sekretari amerikan i shtetit John Kerry, i cili e ka uruar për politikën dhe bashkëpunimin rajonal dhe „ka kërkuar nga kryeministri Vuçiq që, në procesin e pajtimit midis popujve të Ballkanit Perëndimor, të vazhdoj me marrëdhëniet aktive dhe të singerta, që kanë dhënë rezultate të rëndësishme në qetësimin e tensioneve në këtë pjesë të Evropës.“³⁸

“Sjellja e këtillë shembullore” në media edhe më tutje është kombinuar me dyfytërsinë morale, me valëvitjen e gishtit në ajër dhe me “paralajmërimet për qëllimin e mirë”. Kështu, me rastin e gjykimit të Radovan Karaxhiqit dhe Vojislav Sheshelj, Aleksandar Vuçiqi në konferencën për shtyp ka thënë se Tribunali i Hagës „në vend se të shërbejë për pajtimin e popujve në hapësirën e ish Jugosllavisë, gjatë gjithë kohës ka ngulur gozhda në arkivolin e përgjumur të Ballkanit.“³⁹ Me rastin e hapjes së kapitullit 23 dhe 24 në procesin e integriteteve evropiane të Serbisë, Aleksandar Vuçiqi, duke u përgjigjur në pyetjen lidhur me kërkesën e Kroacisë që Serbia të ndryshojë ligjin mbi juridiksionin universal, ka thënë: „Falë atij ligji, ne kemi ndjekur penalisht një numër të madh të kriminelëve, të cilët kanë kryer krime në Srebrenicë. Nuk pajtohem, por nuk e kemi problem që dallimet t'i zgjedhim në marrëdhëniet bilaterale dhe besoj se kemi forcë që mospajtimet reciproke t'i tejkalojmë dhe që të gjejmë zgjidhjet më të mira edhe për Serbinë.“ Vuçiqi ka shtuar se Serbia do të vazhdojë për të punuar në përparimin e politikës rajonale, në respektimin e të drejtave të pakicave "duke mos insistuar gjithnjë në reciprocitetin".⁴⁰

Gjatë vitit, ky kombinim medial i toneve të buta dhe kërcënuese në deklaratat e udhëheqësve politik të Serbisë ka qenë i pranishëm në marrëdhëniet me Kroacinë si dhe me Bosnjën dhe Hercegovinën. Kështu, kryeministri i Serbisë, Aleksandar Vuçiq gjatë muajit mars ka deklaruar se nuk është i befashuar me deklaratën se në B dhe H janë duke shqyrtuar padinë e re për gjenocid kundër Serbisë dhe ka vlerësuar se kryesuesi i Presidencës së B dhe H Bakir Izetbegoviqi me këtë kërkon shkas për inicimin e spirales së re të dhunës. „Për fat të keq, nuk jam i befashuar me lajmin nga Sarajeva. Gjykuar sipas të gjitha gjasave, mirë e kam parandier se dikush nuk e dëshiron pajtimin në rajon, por shkon kundër 35 për qind të popullatës së vendit të vet dhe kërkon çfarëdo arsyeje të mjaftueshme për t'ia filluar spirales, së pari asaj politike, e pastaj kush e di se të çfarë spiraleje të dhunë“, ka thënë Vuçiqi.⁴¹ Duke iu përgjigjur shkrimeve të mediave në B dhe H se prania e tij në komemoracion në Srebrenicë këtë vit është e padëshirueshme, kryeministri i Serbisë në fund të muajit qershor e ka dhënë deklaratën, të cilën e kanë transmetuar të gjitha mediat serbe dhe rajonale: „E pranoj idenë se jemi tepriçë në Srebrenicë. E kuptoj gjithë atë që e thonë dhe ata kanë të drejtë që dikë të mos e dëshirojnë atje. Ata janë tek ne

³⁷ RTS, 7. 7. 2016: “Nënshkruhet marrëveshja për Zyrën Rajonale për të Rinjtë” („Potpisan sporazum o Regionalnoj kancelariji za mlade“).

³⁸ Politika, 18. 7. 2016. Keri i uron Vuçiqit për kapitujt dhe për bashkëpunimin rajonal” („Keri čestitao Vučiću na poglavljima i regionalnoj saradnji“).

³⁹ Politika, 1. 4. 2016. “Vuçiqi: “Serbia e Madhe” nuk është politikë e kësaj qeverie” (Vučić: „Velika Srbija” nije politika ove vlade).

⁴⁰ Danas, 19. 7. 2016. “Një ditë e madhe dhe e rëndësishme për Serbinë” („Veliki i značajan dan za Srbiju“).

⁴¹ N1, 28. 3. 2016. “Vuçiqi lidhur me njoftimin e Izetbegoviqit” („Vučić o najavi Izetbegovića: Neko ne želi pomirenje“).

gjithnjë të mirëseardhur, kurse edhe ne kemi qenë të mirëseardhur tek ata para disa muajsh. Durakoviçin e përjetoj si një mik të Serbisë, një të njohur të mirë timin, dhe ai këtu është gjithnjë i mirëseardhur.", ka thënë Vuçiqi.⁴² Në takimin me presidenten kroate Grabar Kitaroviç në Dalje dhe Suboticë në mesin e muajit qershor, gjë që prapë ka qenë temë e ditës në të gjitha mediat, Vuçiqi në shtëpinë memoriale të Millan Millankoviçit në Dalje është nënshkruar në librin e përshtypjeve me fjalët se Millankoviç „ka qenë ndërtues i urave, se ka ndërtuar ura në realitet, por edhe në kuptimin shpirtëror” dhe ka shtuar se shpreson se "nën kujdesin e frymës së shtëpisë së tij , do të ndërtojmë marrëdhënie më të mira midis popullit serb dhe atij kroat". Me anë të deklaratës, e cila me atë rast është nënshkruar, është arritur pajtimi që, me qëllim të përparimit të marrëdhënieve bilaterale, bashkëpunimit rajonal, qëndrueshmërisë dhe zgjidhjes së çështjeve të hapura midis dy shteteve të fillojnë në mënyrë aktive ose të shpejtohen proceset e përparimit të mbrojtjes reciproke të pakicave – të asaj serbe në Kroaci dhe të asaj kroate në Serbi.⁴³ Vetëm një muaj më vonë, marrëdhëniet midis Serbisë dhe Kroacisë janë ashpërsuar deri në skajshmëri për shkak të aktgjykimeve, me të cilat lirohen nga përgjegjësia kryepeshkopi Stepincac dhe Branimir Glavashi, kontra mitingut të djathtistëve në festimin e ditës së ustashëve në Serbi dhe Likë si dhe ngritjes së përmendores Mira Bareshiqit, të dënuar në Suedi në vitin 1971 për vrasjen e ambasadorit jugosllav Vlladimir Roloviçit, për çka kanë shkruar të gjitha mediat rajonale. Kreu shtetëror serb e ka braktisur tonin e deriatëhershëm të kurtuazisë; ministri i punës Aleksandar Vulin ka deklaruar se „egërsimi i ustashëve në Serbi është skandal dhe turp i tërë Evropës!”⁴⁴, ministri i drejtësisë Selakoviç ka thënë se „Në Kroaci nuk ka as kërkimfalje, nuk ka asgjë, me të cilën Kroacia zyrtare ka bërë për të hequr pengesat e asaj që ka ndodhur”⁴⁵, derisa ministri i punëve të jashtme Ivica Daçiç ka deklaruar se si Serbia „po bënë gjithçka për qëndrueshmërinë dhe dialogun rajonal, por fyerjet, përluljen dhe rehabilitimin e krimeve ndaj serbëve Serbia kurrë nuk do ta lejojë.”⁴⁶ Kulminacioni i tensioneve ka ndodhur pas një festimi me intonacion tejet nationalist të aksionit ushtarak “Oluja” në Knin, ndaj të cilit Beogradi zyrtar ka reaguar në mënyrë shumë të ashpër: kryeministri Vuçiq në vendbanimin Busije në komemoracionin për të rënët dhe të dëbuarit në aksionin ushtarak “Oluja” ka vënë në spikamë se nuk beson në fajin kolektiv dhe që për fatin e keq të të dëbuarve nuk janë fajtor të gjithë kroatët, por individët, të cilët kanë hedhur bomba në rimorkiot e traktorëve dhe ata që i kanë vrarë pleqtë.” Kurse, sa ka të tillë, nuk e kemi për qëllim që t’i numërojmë. Këtë duhet ta bëjnë vet ata”, ka thënë Vuçiqi duke theksuar se Serbia këtë e ka bërë, kur është fjala për ata, të cilët në emër të saj kanë kryer krime.⁴⁷ Ministri i punëve të jashtme Ivica Daçiç e ka vlerësuar si „pafytyrësi” deklaratën e presidentes kroate Kolinde Grabar-Kitaroviç se aksioni ushtarak “Oluja” është „në plan etik fitore e pastër”, e cila i ka „shkarkuar serbët nga barra e projekteve

⁴² B92, 27. 6. 2016. ”Vuçiqi mbi Srebrenicën: E pranojmë se jemi tepriçë” (” Vučić o Srebrenici: Prihvatamo da smo višak”).

⁴³ Tanjug, 20. 6. 2016. “Nënshkruhet Deklarata mbi marrëdhëniet e Serbisë dhe Kroacisë” („Potpisana Deklaracija o odnosima Srbije i Hrvatske”).

⁴⁴ Tanjug, 27. 7. 2016.

⁴⁵ Blic, 3. 8. 2016. “Selakoviç: Nuk do ta ndryshojmë ligjin, sepse këtë e kërkon Tribunali i Hagës” („Selaković: Nećemo menjati zakon jer to traži Haški tribunal”).

⁴⁶ Kurir, 1. 8. 2016. “Daçiç mbi ngritjen e përmendores për Bareshiqin: Kroacinë e udhëheqin trashëgimtarët e ustashëve dhe fashistëve” („DAČIĆ O DIZANJU SPOMENIKA BAREŠIĆU: Hrvatsku vode naslednici ustaša i fašista”).

⁴⁷ Tanjug, 4. 8. 2016. “Vuçiqi: Nuk do të ketë më aksion ushtarak “Oluja” („Vučić: Oluja više neće biti”).

serbomëdha⁴⁸, duke shtuar se kjo përbënë një tregues se për Kroacinë është moralisht e pastër për t'i vrarë disa mijëra serb dhe për t'i dëbuar më shumë se 220 000 sish“, thuhet në deklaratën me shkrim të Daçiqit. Ministri Vulin, megjithëkëtë, ka thënë se si frikohet se ata që janë përgjegjës për dëbimin e serbëve në aksionin ushtarak “Oluja” kurrë nuk do të dënohen, e pakta kështu, ka thënë ai, flasin veprimet e gjykatës ndërkombëtare dhe të asaj kroate: „Megjithëkëtë, mbetet ajo çështja njerëzore: çfarë ka aty madhështore në faktin se e keni dëbuar një popull të tërë, për të cilin keni pohuar se janë qytetar tuajt? A është kjo fitore? Kurrë nuk do të pajtohemi se kjo është arsye për të festuar“, ka thënë Vulin.⁴⁹ Në atë rrebesht të deklaratave, kryeministri Vuçiq iu ka dërguar letër drejtuesve të BE-së duke kërkuar që të reagojnë ndaj „politikës së lakuriqur serbe“ nga Zagrebi, kurse zëdhënësja e Komisionit Evropian Maja Kocijançiq ka pohuar se letra e Vuçiqit kishte arritur dhe se „KE pret nga të gjithë që të respektojnë detyrimet e veta dhe parimet e pajtimit, të fqinjësisë së mirë dhe të bashkëpunimit rajonal”.⁵⁰

Në fund, në shënimin e 75 vjetorit të formimit të kampit të përqendrimit në Jasenovc, në Donja Gradine në Bosnjë e Hercegovinë, kryeministri Vuçiq ka deklaruar se para institucioneve të Serbisë dhe të Republika Srpska qëndron detyra që të vërtetohen emrat e saktë të serbëve të rënë në territorin e ashtuquajtur DRK (NDH), sepse as pas më shumë se 70 viteve kjo nuk është vërtetuar. „Kurrë më nuk do të lejojmë të ndodh as Jasenovci e as Jadovno e as Jastrebarska, por as edhe “Oluja”. Serbët nuk do të shkojnë më në humnerë, nuk do të shkojnë më pa fjalë drejt vdekjes“, ka thënë Vuçiqi.⁵¹ Kjo deklaratë ka shkaktuar reaksion të ashpër të ministrit kroat të punëve të jashtme Kovaçit⁵² dhe ka krijuar hapësirë për ashpërsime të reja.

Bosnja dhe Hercegovina

Mediat me vite raportojnë se kur është fjala për elitën politike të tre popujve në B dhe H, atëherë bëhet fjalë për „luftën e ftohtë të kokave të nxehta“, përkatësisht se atmosfera e elektrizuar qysh prej Dejtonit është bërë „gjendje normale“. ⁵³ Duket se më së shumti pajtim të sinqertë, bashkëpunim dhe shikim drejt së ardhmes në këtë vend ka në deklaratat e aktivistëve të organizatave joqeveritare dhe përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare, por kur është fjala për politikanët boshnjak, atmosfera e kërcënimit të fshehur dhe fryma e vilajetit të errët thuajse janë në mënyrë të pandërprerë të pranishëm. Kështu, edhe deklaratat e këtij viti të atyre politikanëve mbi pajtimin dhe bashkëpunimin kanë qenë të përziera me armiqësitë e vjetra, kurse qëllimet pragmatike të afrimit ndaj institucioneve evropiane kanë qenë të kombinuara me tonet paksa më të ashpra mbi përfaqësuesit politik të bashkësive fqinje, të drejtuar kah zgjedhësit dhe

⁴⁸ Tanjug, 5. 8. 2016. “Daçiq: është pafytyrësi të thuhet se aksioni ushtarak “Oluja” i ka shkarkuar serbët” („Dačić: Bezobrazluk reči da je Oluja rasteretila Srbe“).

⁴⁹ Informer, 4. 8. 2016. “VULIN: “Oluja” kurrë nuk do të jetë asgjë më shumë se sa krim dhe dëbim!” („VULIN: Oluja nikada neće biti ništa više od zločina i pogroma!“).

⁵⁰ N1 Srbija, 2. 8. 2016. “Kocijançiqi: Së shpejti përgjigjja në letrën e Vuçiqit” („Kocijančić: Uskoro odgovor na Vučićevo pismo“).

⁵¹ Tanjug, 19. 8. 2016. “Vuçiqi: Kurrë nuk do të lejojmë një Jasenovc të ri, Jadovnon dhe “Olujën” („Vučić: Nikada nećemo dozvoliti novi Jasenovac, Jadovno i Oluju“).

⁵² N1, 19.8. 2016. “Kovaç: Vuçiqi e nxit popullin kundër Kroacisë” („Kovač: Vučić huška narod protiv Hrvatske“).

⁵³ NIN; 11. 8. 2016. “B dhe H: Vend i përkohësisë së përhershme” („Bih: Zemlja trajne privremenosti“).

simpatizantët vetjak. Kështu, në samitin 100 të liderëve të biznesit të Evropës Juglindore në Sarajevë, anëtari i Presidencës së B dhe H Bakir Izetbegoviqi ka thënë se si “të gjithë kemi bërë gabime” dhe se sot është rruga „që këtë ta pranojmë dhe t’i ndihmojmë njerëzve në Ballkan që të mos ikin prej këtu“. Ai ka thënë se „procesi i pajtimit, i normalizimit të marrëdhënieve dhe i bashkëpunimit është duke shkuar në drejtimin e duhur, por jo mjaftueshëm shpejt.“⁵⁴ Në të njëjtin takim, anëtari kroat i Presidencës Dragan Čović ka thënë se „nuk e kemi ndërtuar deri në fund mirëbesim“, deri sa anëtari i Presidencës së B dhe H nga Republika Srpska Mladen Ivanik iu ka bërë ftesë liderëve nga rajoni për të bërë trysni në B dhe H „me qëllim që ky vend, me hapa më të shpejt e më të mëdhenj të niset drejt nismave rajonale dhe integriteteve evropiane.“⁵⁵ Në ceremoninë e restaurimit të xhamisë Ferhadije në Banja Llukë, Bakir Izetbegoviqi ka thënë se „për ata që Ferhadijen e kanë rrënuar, le të jetë kjo ditë një vërejtje e përhershme“, kurse peshkopi banjallukas Jefrem, në emër të kishës ortodokse serbe iu ka uruar besimtarëve mysliman restaurimin e Ferhadijes, ndërsa kryetari i bashkësisë hebraike në B dhe H Jakob Finci e ka shprehur dëshirën që kurrë më të mos jetë dëshmitarë i rrënimit të tempujve të zotit.⁵⁶ Në manifestimin e 12 vjetorit të hapjes së Urës së Vjetër të restauruar „Mostari nuk i harron miqtë e vet“, në fjalën e tij drejtuar mysafirëve, drejtori i Qendrës për Paqe, Safet Oruçevići ka thënë se si „ndonjëherë është shumë më e vështirë për të punuar në paqe dhe në pajtim se sa të luftohet“, dhe se sot „nuk kemi të drejtë të kthehemi pas, sepse kjo do të ishte rrugë drejt një tragjedie të re për të gjithë popujt tanë“. Është themeluar edhe “Karta e Paqes e Mostarit”, të cilën e kanë nënshkruar kryesuesi i Këshillit të Ministrave të B dhe H Denis, Zvizdiqi dhe kryeministri i Malit të Zi, Milo Gjukanoviqi.⁵⁷

Nga ana tjetër, duke reaguar ndaj lajmërimit mbi ardhjen e kreut politik të Serbisë në festimin e Ditës së Republika Srpska, anëtari i kryesisë së Presidencës së B dhe H, Bakir Izetbegoviqi i është drejtuar publikut me kumtesë dhe ka dhënë porosinë se ai vendim i kryeministrit të Serbisë “është diametralisht i kundërt me heqjen e tij (të Vuçiqit) nga politika serbe, e cila ka çuar deri te luftërat dhe shkatërrimi i vendit”. Izetbegoviqi ka vlerësuar se vizita e Vuçiqit përfaqëson “pranim të gjithë asaj që është bërë në emër të krijesës parashtetërore prej vitit 1992 deri në vitin 1995”.⁵⁸

Kryesuesi i Këshillit të Ministrave të Bosnjës e Hercegovinës, Denis Zvizdiqi ka thënë se vizita e anëtarëve të Qeverisë së Serbisë në ceremoninë e Ditës së RS “në plan afatgjatë, nuk është e mirë ose nuk është vendim konstruktiv dhe se kjo përbënë politikën, të cilën e parapëlqen një pjesë e B dhe H”:

⁵⁴ Avaz, 28. 5. 2016. “SAMITI 100 NË SARAJEVË “Çović: Ndërtimi i besimit në rajon është thelbësor për realizimin e ambicieve” (SAMIT 100 U SARAJEVU „Čović: Izgradnja povjerenja u regiji bitna za ostvarenje ambicija“).

⁵⁵ Po aty.

⁵⁶ Aljazeera Balkans, 7. 5. “Banja Luka: Hapet solemnisht Ferhadija” („Banja Luka: Svečano otvorena Ferhadija“)

⁵⁷ Klix.ba, 15. 7. 2016.

⁵⁸ *Tone gjithnjë e më të ashpra me rastin e ardhjes së Qeverisë Serbe në Ditën e RS* (Sve oštiri tonovi povodom dolaska Vlade Srbije na Dan RS), N1, 25.12.2015. <http://rs.n1info.com/a121209/Svet/Region/Reakcije-na-dolazak-Vlade-Srbije-na-Dan-RS.html>

“Atëherë nuk ka kurrfarë arsyeje që e tërë Qeveria e Serbisë të mos vijë në datën 1 mars dhe që së bashku me ne ta shënojë Ditën e pavarësisë së B dhe H – nëse tashmë duhet pasur një lloj të caktuar të politikës neutrale për të cilën flitet. Me këtë humbet kapaciteti i asaj që njëmend përbënë shembullin e kryeministrit Vuçiq dhe të Qeverisë së Serbisë, e kjo është që në një mënyrë të jenë liderë të proceseve serioze rajonale të pajtimit, të bashkëpunimit në frymën e fqinjësisë së mirë, të marrëdhënieve më të mira ekonomike...Kështu, në njëfarë mënyre, është fjala për vendimet e njëanshme ose për politikën të cilën e parapëlqen vetëm një pjesë e B dhe H dhe e cila nuk është në nivel të pushtetit, të cilin e përfaqëson zotëriu Vuçiq. Nivel i marrëdhënieve është Qeveria e Serbisë me Qeverinë e Bosnjës dhe Hercegovinës. Marrëdhëniet politike shpesh janë një faktor i çrregullimit në marrëdhëniet e tilla, për dallim nga marrëdhëniet e tjera dhe ato ekonomike, të cilat zhvillohen në një rrugë të lartësimit. Secilën herë ato interesa politike partikulare të lidhura për të kaluarën në këto hapësira përzihen në atë mënyrë që asnjëherë këto procese nuk i përparojnë me perspektivë, por na sjellin disa hapa mbrapa”.⁵⁹ Kryetari i Republika Srpska, Millorad Dodik ka deklaruar, sidoqoftë, se Dita e Republikës – 9 janari “festohet si dëshmi e forcimit të saj dhe e përcaktimit për ekzistimin e saj”. Ai në një intervistë për *Glas Srpske* një ditë para ceremonisë qendrore ka thënë se „B dhe H si vend nuk mund të mbijetojë një kohë të gjatë, sepse ekzistenca e saj nuk ka baza reale”.

„B dhe H nuk është kornizë në të cilën Republika Srpska mund të jetë e lirë dhe të zhvillohet. Forcimi i modelit centralist të B dhe H është rrënim i drejtpërdrejtë i Republika Srpska dhe me këtë unë nuk do të pajtohem kurrë. Shumë njerëz këtu nuk i kuptojnë nuancat, kurse nuancë është edhe ajo që B dhe H nuk është shtet.”, ka thënë kryetari RS-së.⁶⁰

Në fjalimin e tij në akademinë solemne Dodik ka deklaruar se RS “është një shoqëri tolerante, e cila nuk bënë diskriminim ndaj popujve të tjerë” dhe ka theksuar se ajo ditë “nuk është rezultat i luftës, por i vullnetit politik të popullit në këto hapësira”.⁶¹

Anëtari i Presidencës së B dhe H Bakir Izetbegoviqi ka thënë me rastin e aktgjykimit të Tribunalit të Hagës për Radovan Karaxhiqin: “Radovan Karaxhiqit sot nga ana e Tribunalit të Hagës i është caktuar dënimi me 40 vite burgosje. Për njeriu në moshë si ai dhe me të kaluarën e tij kjo edhe nuk është ndonjë dënim i veçantë. Dhe kjo, për viktimat e B dhe H nuk ka domethënie të veçantë. Ajo që ka rëndësi të veçantë është fakti se aktgjykimit i është shqiptuar një ideologjie të tmerrshme dhe politikës. [...]

⁵⁹ *Zvizdiqi e ka kritikuar vizitën e anëtarëve të Qeverisë së Serbisë në Ditën e RS (Zvizdić kritikovao dolazak članova Vlade Srbije na Dan RS)*, N1, 24.12.2015. <http://rs.n1info.com/a120898/Svet/Region/Zvizdic-kritikovao-dolazak-clanova-Vlade-Srbije-na-Dan-RS.html>.

⁶⁰ *Dodik: Dita e Republika Srpska festohet si provë e forcimit të saj* RTS 08.01.2016. (Dodik: Dan Republike Srpske slavi se kao dokaz njenog jačanja, RTS, 08.01.2016.) <http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/11/region/2166817/dodik-dan-republike-srpske-slavi-se-kao-dokaz-njenog-jacanja-.html>.

⁶¹ *Vuçiqi në Banja Llukë: Dashuria ndaj RS nuk do të thotë urrejtje ndaj B dhe H*, Radio Slobodna Evropa, 09.01.2016. (*Vučić u Banjoj Luci: Ljubav prema RS ne znači mržnju prema BiH*, Radio Slobodna Evropa, 09.01.2016. <http://www.slobodnaevropa.org/a/dan-republike-srpske-2016/27477996.html>).

Aktgjykimi për Radovan Karaxhiqin është aktgjykimi më i rëndësishëm për krime të luftës pas aktgjykimit të udhëheqësve nazist në vitin 1945 në Nirmberg. Aktgjykimi për Radovan Karaxhiqin i ka të gjitha elementet e krimit, natyrisht në një hapësirë më të vogël, si edhe ato krimet tjera që janë ndjekur penalisht në Nirmberg. Disa njerëz pohojnë se për luftën në B dhe H ekzistojnë tri të vërteta. Mund të ekzistojnë vetëm më shumë gjysmë të vërteta. E vërteta është një dhe ajo që në këtë botë të papërsosur i është më e afërta është vizioni, gjykimi dhe aktgjykimi i Tribunalit të Hagës. Dhe ky gjykim dhe aktgjykim prapëseprapë është njerëzor dhe në te në mënyrë evidente kanë ndikuar interesat politike dhe vlerësimet. Aktgjykimi nuk është shqiptuar për gjenocidin e kryer në Bratunc, Foçë, Ključ, Prijedor, Sanski Most, Vlasenica dhe Zvornik. Besojmë dhe shpresojmë se këtë padrejtësi do ta korrigjojë Paneli Ankimor ashtu siç ka bërë më herët në aktgjykimin e përkohshëm për Radovan Karaxhiqin”.⁶²

Kryetari i i RS Milorad Dodik ka deklaruar se është “absolutisht e qartë se aktgjykimi për kryetarin e parë të Republika Srpska Radovan Karaxhiqin në Hagë me 40 vite burgosje është sjellë nën trysninë e fuqishme të lobeve të ndryshme ndërkombëtare dhe stereotipeve të mëhershme mbi fajin ekskluziv serb për luftën në B dhe H”.

"Për shumë raste në Tribunalin e Hagës është e njohur se nuk janë bazuar gjithmonë në faktet, por se në masë të madhe janë motivuar edhe me motive politike si dhe me aktakuza dhe aktgjykime paraprakisht të sajura", ka thënë Dodik dhe ka shtuar se “në mbështetje të kësaj flet edhe fakti se pothuajse e tërë udhëheqja politike dhe ushtarake e serbëve është ndjekur penalisht, kurse ka munguar përgjegjësia e të tjerëve, siç është Naser Oriqi, të cilët lirisht shëtisin nëpër Sarajevë dhe, siç thuhet, mbrojnë diçka nga liria, kurse në ndërkohë i shkatërrojnë dëshmitarët dhe me kërcënime i ndryshojnë deklaratat e tyre”.

"Pjesa tjetër është e dukshme dhe edhe ajo se— rastësisht ose jo — për shqiptimin e aktgjykimit [Karaxhiqit], është zgjedhur dita kur ka filluar bombardimi i Serbisë. Në këtë pikëpamje, njerëzit në Srpska e kanë ndjenjën e tyre dhe unë i ndjej dhe e di ", ka thënë Dodik.⁶³

Në Konferencën e Tretë „Platformat e dialogut“ në organizim të KB-ve dhe të Presidencës së B dhe H në fund të muajit qershor në Sarajevë ka folur Bakir Izetbegović: „Dëshiroj edhe njëherë për të theksuar se procesi i pajtimit në shoqërinë e bh është procesi më i rëndësishëm themelor, në të cilin bazohen të gjitha proceset pozitive në shoqëri dhe në shtet. Nëse ai shkon në mënyrën e duhur, gjithçka tjetër në këtë shtet dhe në këtë shoqëri shkon në mënyrën e duhur.”⁶⁴ Nga ana tjetër, të gjithat mediat e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe ato të rajonit e kanë regjistruar, pas

⁶² Izetbegović lidhur me aktgjykimin për Karaxhiqin: Kjo është një ditë historike për B dhe H, Faktor.ba, 24.03.2016 (Izetbegović o presudi Karadžiću: Ovo je historijski dan za BiH, Faktor.ba, 24.03.2016, <http://faktor.ba/izetbegovic-o-presudi-karadzicu-ovo-je-historijski-dan-za-bih-foto/> .)

⁶³ Dodik: Aktgjykimi për Karaxhiqin është sjellë nën trysni, Srna/N1 BiH, 24.03.2016. (Dodik: Presuda Karadžiću donesena pod pritiskom, Srna/N1 BiH, 24.03.2016. <http://ba.n1info.com/a87757/Vijesti/Vijesti/Dodik-Presuda-Karadzicu-donesena-pod-pritiskom.html> .)

⁶⁴ Faktor.ba 27. 6. 2016.

aktgjykimit të Hagës për Radovan Karaxhiqin, deklaratën e Bakir Izetbegoviqit mbi mundësinë që Bosnja dhe Hercegovina e kërkon revidimin e akuzës kundër serbëve për gjenocid në B dhe H. "Do të thellohen në vet aktgjykimin dhe në përmbajtjen e tij dhe do të shohin nëse ka elemente të reja. Nëse do të ketë, nuk do të ikim nga kjo. Nuk do t'a fusim nën tepih vuajtjen, nëpër të cilën kanë kaluar këta popuj dhe ky vend dhe do t'ia fillojmë revidimit, porse na është i nevojshëm një provë e re.", iu ka thënë gazetarëve Izetbegoviqi.⁶⁵

Ngaqë jemi duke iu afruar komemoracionit të viktimave në Srebrenicë, porositë në marrëdhëniet e B dhe H dhe të Serbisë janë bërë gjithnjë e më ambivalente. Kështu, Izetbegoviqi ka deklaruar se si „kreu shtetëror i Serbisë nuk është i padëshirueshëm në Srebrenicë“⁶⁶, derisa Këshilli organizativ për komemoracion për viktimat srebrenicase ka marrë qëndrimin se kreu i Serbisë është i padëshirueshëm në komemoracion në Potoçari... Kryetari i komunës së Srebrenicës, Qamil Durakoviqi, sidoqoftë, ka thënë me rastin e donacionit të sivjetmë të Serbisë për Srebrenicën se si shpreson se „Aleksandar Vuçiqi nuk ka menduar se me anë të donacionit do të parapaguhet për hyrjen në Qendrën Memoriale: „Kreu shtetëror i Serbisë gjithsesi se është i dëshirueshëm në komemoracion, por para kësaj duhet që publikisht të pranojë se në muajin korrik të vitit 1995 Ushtria e RS në Srebrenicë ka kryer gjenocid“, ka thënë kryetari i Srebrenicës.⁶⁷

Në vet komemoracionin, Durakoviqi ka thënë se si „e vërteta dhe drejtësia janë po aq të nevojshme edhe për boshnjakët dhe serbët“, duke porositur se vetëm në këtë mënyrë është e mundshme për të ngritur themelet e përparimit.⁶⁸ Në komemoracion ka folur edhe Bakir Izetbegoviqi: „Vetëm atëherë, atëherë kur edhe pa më të voglën rezervë i vendosim gjërat në vendin e tyre, vetëm atëherë kur të heqim edhe më të voglin dyshim mbi atë – se kush ka qëndruar në anën e drejtë e kush në atë të shtrembër të historisë, do t'i zgjidhim ndasitë dhe ngarkesën e së kaluarës.“⁶⁹ Kryetari i Republika Srpska Milorad Dodik, megjithëkëtë, duke e shpjeguar se përse këtë vit nuk do të shkojë në Srebrenicë, ka thënë se e kupton dimensionin e dhembjes dhe të pësimit, por se nuk dëshiron të marrë pjesë në dimensionin e politizimit.⁷⁰ Tensione të reja ka sjellë edhe referendumi i paralajmëruar në Republika Srpska, i caktuar për datën 25 shtator, në të cilin do të vendoset mbi datën e festës së Republika Srpska (është propozuar data 9 janar – data e themelimit të RS-së 1992), gjë që kryetari i Presidencës së B dhe H Bakir Izetbegoviqi e ka quajtur „lojë me zjarrin“, kurse Millorad Dodiku „mjet politik të realizimit të qëllimit kombëtar“.⁷¹

⁶⁵ Al Jazeera Balkans, 28. 3. “Izetbegoviqi: Jemi duke e shqyrtuar revidimin e padisë kundër Serbisë”(„Izetbegović: Razmatramo reviziju tužbe protiv Srbije“).

⁶⁶ N1 B dhe H (BiH), 29. 6. 2016.

⁶⁷ Nezavisne novine, 29. 6. 2016.

⁶⁸ Vijesti BiH, 11. 7. 2016.

⁶⁹ Faktor.ba, 11. 7. 2016. “Izetbegoviqi në Potoçari: Politikat, të cilat kanë çuar deri te Srebrenica dhe Vukovari, duhet të braktisen” („Izetbegović u Potočarima: Politike koje su dovele do Srebrenice i Vukovara moraju biti napuštene“).

⁷⁰ Aljazeera Balkans, 3. 7. 2016. “Dodik: Nën timer të Srebrenicës – një shoqatë politike” („Dodik: Majke Srebrenice političko udruženje“).

⁷¹ Oslobođenje, 29. 7. 2016. “Izetbegoviqi: Dodiku po luan me zjarr; Dodiku: Izetbegoviqi nuk mund të drejtojë njerëzit në RS” („Izetbegović: Dodik se igra s vatrom; Dodik: Izetbegović ne može upravljati ljudima u RS-u“).

Në mënyrë përfundimtare, ajo që në tetë muajt e parë të vitit 2016 nuk ka zgjuar një optimizëm të theksuar në deklaratat si të udhëheqësve të Bosnjës e Hercegovinës, ashtu edhe të atyre nga vendet e tjera të rajonit, është se ato kanë qenë të ngarkuara me marrëdhëniet e tendosura politike, që kanë qenë të pranishme në marrëdhëniet midis këtyre shteteve. Në këtë kuptim duhet edhe njëherë ta kujtojmë atë vlerësimin objektiv të gazetës lubjanase *Dela* mbi perspektivat e bashkëpunimit dhe të pajtimit, si në B dhe H ashtu edhe në rajon, të shqiptuara nga fundi i muajit maj pas samitit vjetor “Brdo-Brione” në Sarajevë: kjo perspektivë nuk është e madhe, sepse shkalla e ulët e demokracisë është karakteristikë e përbashkët e tërë Ballkanit ...

Mali i Zi

Shteti malazias po përpiqet vitet e fundit që në mënyrë konsekuente të përcjellë parimet e lidhjes dhe të pajtimit rajonal midis, deri kohët e fundit, popujve të përçarë të Ballkanit dhe, së këndejmi, është përpjekur që të jetë i pranishëm edhe në proceset e gjera integruese evropiane. Në këtë kuptim, gjatë tetë muajve të parë të vitit 2016 është vërejtur prania e kryeministrit malazias Mile Gjukanoviq dhe e krerëve të tjerë shtetëror në takimet me rëndësi rajonale dhe evropiane, siç është Panairi Ndërkombëtar i Ekonomisë në Mostar, samiti vjetor “Brdo-Brione” në Sarajevë ose samiti i shefave të shteteve dhe qeverive “Paris – Ballkan 2016” në Paris – si pjesë e procesit të Berlinit të filluar në vitin 2014. Aktive kanë qenë edhe organizatat joqeveritare malazeze në fushën e bashkëpunimit rajonal dhe në këtë kuptim gjithsesi se për ta ngjarja më e rëndësishme është nënshkrimi i Deklaratës mbi themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunimin e të Rinjve.

Përfaqësuesit e grupit nacional serb të Komisionit Trelateral, të organizatës ndërkombëtare për ndërlidhje të popujve të botës, së bashku me anëtarët e bashkuar nga Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina, në fillim të muajit korrik në Podgoricë kanë biseduar me kryeministrin malazias Mile Gjukanoviqin. Në këtë bisedë, Gjukanoviqi e ka vënë në spikamë se bashkëpunimi rajonal midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe vendosja e marrëdhënieve sa më të afërta ekonomike dhe politike bëhet imperativ për zhvillimin e ardhshëm dhe sigurinë e rajonit, duke i pasur parasysh sfidat e rënda të shkaktuara me ngjarjet më të fundit në Evropë.⁷²

Nga fundi i muajit korrik, kryeministri i Malit të Zi është takuar në Mostar me kryesuesin e Këshillit të Ministrave të Bosnjës e Hercegovinës, Denis Zvizdiqin, me të cilin ka biseduar për përparimin e bashkëpunimit rajonal dhe proceset integruese në rajon.⁷³ Kryeministrat pastaj kanë nënshkruar “Kartën e Paqes të Mostarit” në tavolinën e punës së poetit mostaras Aleksa Shantiqit dhe kanë qenë të pranishëm në ceremoninë e ndarjes së shpërblimit ndërkombëtar për paqe “Mostar peace connecton” (Lidhja paqësore e Mostarit) ish kryetarit të Francës Jacques Chiracut, ish administratorëve evropianë të Mostarit Sir Martin Garrodit, Hans Koschnikut dhe Ricard Perez Casadit, ish drejtorit gjeneral të UNESCO-s Federicu Mayorit dhe kryeprokurorit të Tribunalit të Hagës Sergeu Brammertit, të cilin tradicionalisht e ndanë Qendra për Paqe dhe bashkëpunim shumetnik, Mostar.

⁷² Vijesti, 1. 7. 2016.

⁷³ <http://sens-tv.eu/> 24. 7. 2016.

Në samitin “Brdo-Brione” në Sarajevë në fund të muajit maj të vitit 2016, kryetari i Malit të Zi Filip Vujanoviqi ka thënë se si nisma “Brdo-Brionet” në masë të madhe ka realizuar ambicien e saj, por para tyre ende ka shumë detyra. “Mendoj se është një ambicie afatgjatë, të cilën do ta realizojnë edhe gjeneratat e ardhme. Në zgjidhjen e çështjeve ekonomike e shohin shansin që të zgjidhim çështjet e hapura, të cilat janë të shumta në rajon. Mund t’i zgjidhim ato vetëm në kuadër të një ambienti të mirë ekonomik. Kur flitet për politikën shpesh i kthehemi së kaluarës, kurse, në të vërtetë, duhet t’i drejtohem të ardhmes, ky është obligimi ynë.”⁷⁴

Kryeministri Gjukanoviq ka qenë nga mesi i vitit edhe në vizitë zyrtare Argjentinës, ku ka biseduar me kryetarin Maurisio Makrije dhe në Këshillin argjentinës për marrëdhëniet ndërkombëtare CARI ka mbajtur ligjëratë në temën „Bashkëpunimi rajonal në hapësirën post-jugosllave dhe perspektiva evropiane e Ballkanit Perëndimor”.⁷⁵ Në bisedë me *Deutsche Welle* në fillim të vitit, Gjukanoviqi po ashtu ka thënë se si ftesa e NATO-s që Mali i Zi t’i bashkohet kësaj organizate është kurorë e përpjekjeve reformuese të Malit të Zi – nga shpallja e pavarësisë deri më sot. „Për Malin e Zi këtë e shohim si një kthesë historike, në kuptimin e vendimit mbi përkatësinë e një sistemi të ri të vlerave – sistemit të vlerave të bashkësisë euroatlantike. Po ashtu, mendojmë se është një moment i rëndësishëm për përparimin e mëtejshëm të qëndrueshmërisë dhe të zhvillimit të rajonit të Ballkanit Perëndimor.”⁷⁶

Drejtori i përgjithshëm për çështje multilaterale dhe bashkëpunim rajonal në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Integritet Evropiane i Malit të Zi, Millorad Shqepanoviq, ka qenë i pranishëm në takimin vjetor të Këshillit për bashkëpunim rajonal (RCC) në Bullgari dhe me atë rast ka thënë se „Mali i Zi është i përkushtuar për lidhjen dhe bashkëpunimin e vendeve të Evropës Juglindore si dhe se, së këndejmi, një vëmendje të veçantë i kushton bashkëpunimit rajonal dhe aktiviteteve në kuadër të Procesit të Bashkëpunimit në EJT (JIE) (SEECP), që i kontribuojnë realizimit të qëllimeve në procese më të gjera integruese.”⁷⁷

Kryetari i Kuvendit të Malit të Zi, Darko Pajovq, ka marrë pjesë në fund të muajit gusht në Bratisllavë në Konferencën Ndër-parlamentare mbi politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, ku ka mbajtur ligjëratë në temën „Bashkimi Evropian si faktor global, kërkimi i modelit diplomatik multilateral efikas”. Pajoviqi ka përkujtuar se përvojat negative të pacifikimit të konflikteve në Evropën Juglindore kanë treguar se nuk ka qëndrueshmëri të Evropës pa sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të Ballkanit. “Për këtë arsye, dëshiroj ta vë në spikamë se vazhdimi i politikës së zgjerimit është me rëndësi të veçantë, si instrumenti më i mirë për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe pajtimin në Ballkanin Perëndimor, pa inkorporimin e të cilit BE nuk është complete. Së këndejmi, është me shumë rëndësi edhe për shtetet në procesin e zgjerimit, edhe për vet idenë e zgjerimit të BE-së, fakt që është një nga prioritetet e kryesimit sllovak pikërisht politika e zgjerimit të BE-së, me çka vërtetohet se njëra nga politikat më të suksesshme të BE-së nuk ka ngecur në këto kohë sfiduese për Unionin”, ka theksuar Pajoviqi.⁷⁸

⁷⁴ <http://www.nezavisne.com/>

⁷⁵ <http://www.cdm.me/> 3. 6. 2016.

⁷⁶ <http://www.dw.com/> 14.02.2016

⁷⁷ <http://www.cdm.me/> 31 Maj, 2016

⁷⁸ <http://www.cdm.me/> 3. 9. 2016.

Pos këtyre deklaratave konstruktive të zyrtarëve të lartë shtetëror të Malit të Zi, në drejtim të bashkëpunimit dhe pajtimit, ajo që është në mënyrë të përhershme e pranishme si një hije e këtyre përpjekjeve politike është tendosja e pandërprerë midis partive në pushtet (DPS) dhe opozitës, gjë që gjithsesi e vështirëson procesin për të cilin është fjala. Kjo është edhe më e rëndësishme ngaqë marrëdhëniet e çrregulluara politike brenda Malit të Zi gërshetohen edhe në marrëdhëniet e Serbisë dhe të Malit të Zi, në të cilin jeton një numër i rëndësishëm i banorëve të nacionalitetit serb.

Kosova

Marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë në tetë muajt e parë të vitit 2016 janë zhvilluar në atmosferën e një qëndrueshmërie të matur, sa ka qenë e mundur kjo në rrethanat të cilat ende janë të ngarkuara me përkujtimin e ngjarjeve të mbushura me dhunë gjatë dy dhjetëvjjetëshave të kaluar. Ajo që brengos janë incidentet sporadike; të shtënat në shtëpitë serbe nga kryerës të panjohur⁷⁹, kërcënimet, kufizimi i dhunshëm i lëvizjes⁸⁰ dhe deklaratat shqetësuese në publik⁸¹, kurse ajo që inkurajon janë qëndrimet e përfaqësuesve të organeve më të larta shtetërore, të shqiptarëve dhe serbëve, si dhe të liderëve të partive politike, të cilat janë të motivuara me qetësimin e tensioneve, me dëshirën për pajtim, me gatishmërinë për kënaqjen e drejtësisë dhe me veprimin e shtetit të së drejtës dhe me bashkëpunimin e dy popujve në Kosovë dhe bashkësive të tjera. Një proces i cili zgjat është implementimi i Marrëveshjes së Brukselit⁸², i cili nuk po zhvillohet shpejt dhe rrjedhshëm, por rreth tij po investohen përpjekje të pandërprera të palëve të përfshira. Ajo që është më e rëndësishmja është se liderët, të cilët drejtojnë institucionet më të larta shtetërore të Kosovës janë të interesuar për dialogun, bashkëpunimin dhe pajtimin ndërnacional.

Kështu, presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga ka pranuar në datën 16 shkurt kryetaren e Republikës së Maltës, Shkëlqesinë e Saj zonjën Marie Louise Coleiro Preca, e cila ka qëndruar në vizitë zyrtare ndërshtetërore Kosovës. Në fjalën e saj me të cilën i drejtohet mysafires së saj, Jahjaga ka deklaruar: „Rruga evropiane është rruga e pashmangshme e gjithë vendeve të rajonit të Ballkanit, që duhet të mësohen me realitetin e ri të krijuar, duke ndërtuar marrëdhënie të mira fqinjësore, që çon drejt një pajtimi të madh në Ballkan.“⁸³

Në fjalën e tij inauguruese në datën 8 prill të vitit 2016, presidenti i sapo zgjedhur i Kosovës, Hashim Thaçi e ka cekur edhe dialogun e dyfishtë – i cili në Kosovë zhvillohet me bashkësitë

⁷⁹ 26. 2. 2016. <http://www.telegraf.rs/> “ME BOMBA DHE ME GURË NË SHTËPITË E SERBËVE NË KOSOVË” („BOMBOM I KAMENICAMA NA SRPSKE KUĆE NA KOSOVU“

⁸⁰ <http://www.b92.net/> “Thaqi dhe Veseli: Nuk na është dashur ajo që ka ndodhur dje në Mushitisht” („Taçi i Veseli: Nije nam trebalo ono juče u Mašutištu“).

⁸¹ Tanjug | 31. 08. 2016. “Kurti: E kemi ndaluar AKS-në, do ta ndalim edhe demarkacionin me MZ” („Kurti: Zaustavili smo ZSO, zaustavićemo i demarkaciju sa CG“).

⁸² 24. 8. 2016. "Epoka"

⁸³ Presidentja Atifete Jahjaga priti presidenten e Maltës, Marie Louise Coleiro Preca, Presidency web, 16.02.2016: <http://www.president-ksgov.net/?page=1.6.4236#.V8m2P1R97IU>

minoritare, dhe atë në Bruksel me Serbinë. „Ne duhet të vazhdojmë rrugëtimin tonë evropian dhe dialogun me Serbinë, sepse qytetarët na kanë obliguar ta anëtarësojmë Kosovën sa më shpejtë në BE dhe NATO. Ky është një obligim dhe detyrim nacional që edhe në momentet më të vështira, edhe në bisedat më të rënda dhe në çastet më provokuese, mos t’i dorëzohemi dëshpërimit, mos të dorëzohemi para urrejtjes. Ne do të ndërtojmë fqinjësinë e mirë. Dialogu nuk ka alternativë. Kosova dhe Serbia duhet të kalojnë nga faza e normalizimit të marrëdhënieve në procesin e pajtimit në mes të dy shteteve dhe dy popujve. Jam i bindur se pajtimi do të ndodh.”⁸⁴

Në lidhje me bashkëpunimin rajonal, ai ka deklaruar: „Marrëveshja e Brukselit nuk është një ishull. Ajo solli relaksim raportesh politike në gjithë rajonin tonë. Sot Ballkani dhe gjithë rajoni është ndryshe. Secili komunikon me secilin. Së bashku me Planin e Ahtisarit dhe Marrëveshjen e Rambujesë – ajo është edhe një pikë referuese e historisë sonë moderne, e arkitekturës së paqes në Ballkan.”⁸⁵

Gjatë vizitës së zëvendës-sekretarit të SHBA-ve Joe Biden Kosovës, në datën 17 gusht Thaçi i ka premtuar Bidenit se do të arrihet deri te pajtimi midis Kosovës dhe Serbisë. "Për më tepër ne kemi shënuar hapa të rëndësishme në normalizimin mes Kosovës dhe Serbisë. Ne kemi arritur marrëveshjen historike të prillit të vitit 2012. Ne e kemi për detyrë t’i japim dinamikë të re dialogut dhe sa më shpejt të vie pajtimi mes dy shteteve të pavarur. Jam i sigurt që pajtimi do të ndodhë", ka theksuar Thaçi.⁸⁶

Në një intervistë me gazetë ditore austriake *Tiroler Tageszeitung* të datës 26 prill të vitit 2016, presidenti Thaçi, në pyetjen mbi procesin e dialogut dhe të normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë është përgjigjur se normalizimi i marrëdhënieve, dialogu dhe pajtimi nuk kanë alternativë. " Si në Kosovë, ashtu edhe në Serbi, kryeministrat të cilët udhëhoqën dialogun fituan sërish në zgjedhjet e përgjithshme, duke dëshmuar se popullsia mbështet procesin e dialogut", ka shtuar Thaçi. Ai prapë e ka vënë në spikamë se procesi i dialogut duhet të bëhet më dinamik, në atë mënyrë që të arrihet deri te marrëveshja kornizë mbi pajtimin. Megjithëkëtë, e thekson Thaçi, dinamika duhet të ekzistojë edhe në zbatimin e marrëveshjeve, për të cilat është arritur deri tash pajtimi.⁸⁷

Në intervistën për *Zërin e Amerikës*, në datën 15 prill, presidenti Thaçi, midis të tjerash, në çështjen mbi negociatat me Serbinë është përgjigjur: " Dialogu për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë ka pasur rezultate pozitive edhe për Kosovën, Serbinë dhe rajonin.(...) Do të punohet maksimalisht që të zbatohen të gjitha marrëveshjet. Unë besoj

⁸⁴ Fjalimi i Presidentit Thaçi në ceremoninë e inaugurimit, Precidency web, 08.04.2016: <http://www.president-ksgov.net/?page=1.6.4327#.V8mz8VR97IU>

⁸⁵ Po aty.

⁸⁶ Thaçi: Pajtimi mes Kosovës dhe Serbisë do të ndodhë, Gazeta Express, 17.08.2016: http://www.gazetaexpress.com/lajme/thaci-pajtimi-mes-kosoves-dhe-serbise-do-te-ndodhe-240708/?utm_source=website&utm_medium=RA&utm_content=Hashim%20Thaci,Joe%20Biden,Serbia&utm_campaign=InsideArticle&past_aid=

⁸⁷ Hashim Thaci: "Nuk ka asnjë alternativë për dialogun" („Es gibt keine Alternative zum Dialog“, *Tiroler Tageszeitung* Online), 26.04.2016: <http://www.tt.com/politik/11421638-91/hashim-thaci-es-gibt-keine-alternative-zum-dialog.csp>

fuqishëm se nga procesi i normalizimit të marrëdhënieve mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë duhet të kalojmë në fazën e pajtimit. Unë besoj në pajtimin në mes të kombeve dhe shteteve tona ndërsa sa i përket rajonit ka pasur reflektime. Ju mund të imagjinoni se nuk do të ndodhte asnjë vizitë e kryeministrit të Shqipërisë në Beograd pas gjashtë dekadave të raporteve të ngrira sepse e ardhmja e relacioneve shqiptare dhe serbe kalon përmes Prishtinës. Nëse Prishtina ka raporte korrekte me Beogradin atëherë reflektohet në të gjithë rajonin kudo që jetojnë shqiptarët, ndërsa nëse ato tensione janë në mes Prishtinës dhe Beogradit reflektohen në kuptimin negativ dhe gjithashtu pastaj edhe vizita e kryeministrit të Serbisë në Tiranë, por edhe në relacionet tjera që ka Kosova të shkëlqyera me vendet tjera të rajonit."⁸⁸

Në shënimin e Ditës së Personave të Pagjetur, në datën 27 prill të vitit 2016, presidenti Thaçi e ka vizituar fshatin Meje të Gjakovës, ku ka thënë se për punë të suksesshme në ndërtimin e të ardhmes, në të cilën të gjithë do të jemi të barabartë, është e nevojshme që të ballafaqohemi edhe me të kaluarën. " Duhet drejtësi për viktimat e luftës. Drejtësi për të gjitha viktimat, pa dallim etnie", ka thënë presidenti. Presidenti Thaçi e ka vënë në spikamë se Kosova është treguar e vullnetshme për të bashkëpunuar me të gjithë, për të marrë mbi vete secilin obligim, për të hulumtuar dhe për të gjykuar krimet e kryera, pa marrë parasysh nga fakti se kush është kryerës dhe ku janë kryer ato krime. Por, " kjo duhet të kërkohej nga të gjithë në rajonin tonë", ka thënë Thaçi, duke shtuar se është dëshmuar pjesëmarrja e shtetit të Serbisë në krimet e kryera në Kosovë. " Serbia ka kryer gjenocid në Kosovë, por populli ynë është i vendosur që të shikojë nga e ardhmja më e mirë për gjeneratat e reja ", ka thënë presidenti Thaçi. Ai ka thënë se është e nevojshme të punohet më shumë në sigurimin e të ardhmes evropiane, në arritjen e drejtësisë për të gjitha viktimat e luftës si dhe në vendosjen e pajtimit.

Gjatë takimit me nënsekretaren e SHBA-ve, Victoria Nuland, presidenti Thaçi ka thënë se si Kosova i nxit marrëdhëniet e mira fqinjësore, duke e përfshirë këtu edhe Serbinë. " Është koha për një kualitet të ri në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, që do të sjell pajtim dhe marrëdhënie fqinjësie më të mira dhe më bashkëpunuese", ka thënë presidenti Thaçi.⁸⁹

Presidenti Thaçi në datën 20 gusht të vitit 2016 ka vënë kurora në memorialin e 14 banorëve serb të vrarë menjëherë pas përfundimit të luftës, para 17 vitesh, në fshatin Staro Gracko të Lipjanit. Ai ka deklaruar: "Sot lutem me dhimbje dhe shpreh edhe një herë keqardhje për të gjitha viktimat gjatë dhe pas luftës, të të gjitha komuniteteve. Çdo krim duhet të zbardhet dhe të ndëshkohet. Krimi është krim kundër kujtdo qoftë të jetë bërë apo nga kushdo qoftë që është kryer", ka thënë presidenti Thaçi. Po ashtu ka thënë se duhet të ndriçohet njëherë e përgjithmonë fati i të gjithë personave të zhdukur, qoftë kur është fjala për shqiptarët, serbët, qoftë për pjesëtarët e cilësdo bashkësi tjetër. "Të gjithë kemi përgjegjësi të punojmë në këtë drejtim. Kemi përgjegjësi para familjeve të tyre dhe të ardhmes së fëmijëve tonë. Ne duhet ta ndihmojmë njeri-

⁸⁸ Intervistë me Presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, Zëri i Amerikes, 15.04.2016:
<http://www.zeriamerikes.com/a/kosovo-thaci-interview/3287144.html>

⁸⁹ Thaçi-Nuland: Demarkacioni duhet të miratohet sa më parë, Koha.net, 10.07.2016:
<http://koha.net/?id=27&l=122874>

tjetrin. Dhimbja e çdo nëne është e njëjtë për humbjen e familjarëve të vet", ka deklaruar presidenti Thaçi. Ai ka thënë se sot, kur po punojmë në ndërtimin e paqes, në pajtimin dhe bashkëpunimin midis popujve në rajonin tonë, është me rëndësi për të theksuar se për pajtimin e sinqertë është i domosdoshëm kënaqja e drejtësisë. "Si Kosovë, kemi arritur shumë në këto 17 vite që nga lufta. Kemi filluar të ndërtojmë ura të komunikimit dhe të bashkëpunimit. Në një ditë të afërt, kjo do të sjellë besim dhe pajtim mes komuniteteve dhe popujve", ka thënë presidenti Thaçi. Ai ka theksuar se vetëm përmes kënaqjes së drejtësisë është e mundur të arrihet deri te pajtimi dhe se, duke qenë se ekziston vullneti për te, pajtimi do të bëhet në të ardhmen e afërt. " Vetëm pajtimi dhe bashkëpunimi e bën Kosovën dhe rajonin vërtetë europian", ka përfunduar presidenti Thaçi.⁹⁰

Në datën pesëmbëdhjetë gusht të vitit 2016, presidenti Thaçi është përulur edhe para fëmijëve të vrarë në Gorazhdevc (Goraždevac) të Pejës në sulmin ende të pasqaruar të datës 13 gusht të vitit 2003. " Sot vura kurorë lulesh në këtë memorial për të përkujtuar sulmin kriminal kundër të rinjve të fshatit Gorazhdec, 14 vite më parë, në të cilin u vranë dy të rinj e u plagosën katër të tjerë ", ka deklaruar presidenti Thaçi para gazetarëve të mbledhur dhe ka shtuar se "e drejta në jetë është e drejta themelore e të gjithëve ". "Kështu është dashur të jetë edhe për rreth 400 fëmijë shqiptarë nën moshën 15 vjeçare, të cilët janë vrarë gjatë luftës nga shteti i Serbisë", ka thënë presidenti Thaçi, i cili e ka vënë në spikamë se "për fat të keq, këta fëmijë këtu i ka vrarë dora kriminale dhe dora e shtetit ". Pastaj ka përsëritur: "Sot, kur po punojmë për të ndërtuar paqe, pajtim dhe bashkëpunim mes popujve të rajonit, është e rëndësishme të theksojmë se për pajtim të sinqertë është e domosdoshme drejtësia. Pajtimi në mes shqiptarëve dhe serbëve është i mundur dhe do të ndodhë". "Ky hap do të thotë paqe për rajonin", ka përfunduar presidenti Thaçi.⁹¹

Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës dhe shefi i zyrës për bashkësitë në Gorazhdevc, Sllobodan Petroviqi ka vlerësuar se është shumë e rëndësishme që presidenti i Kosovës Hashim Thaçi ka shkuar në atë fshat dhe që i ka vendosur kurorat në memorialin e të rinjve serb të vrarë para 13 vitesh. „Në Kosovë gjithmonë është kështu, nëse para dite është mirë, padite mund të shpërthejë. Tash situata është e mirë, nuk e di se si do të jetë nesër. Kjo varet nga institucionet dhe njerëzit, të cilët e udhëheqin Kosovën.“, ka thënë Petroviqi.⁹²

Fjala e presidentit Thaçi në ceremoninë e hapjes së Rugës Beau Bidena, në datën 17 gusht, ka pasur të bëjë edhe me pajtimin, në pjesën në të cilën ka deklaruar se " Nëse plotësisht

⁹⁰ Presidenti Thaçi nderon 14 serbët e vrarë në Grackë të Lipjanit para 17 vjetësh, Koha.net, 20.07.2016: <http://koha.net/?id=&l=124661>

⁹¹ Thaçi në Gorazhdec: Askush nuk do të mund të vrasë të ardhmen, RTK Live, 15.08.2016: <http://www.rtklive.com/sq/news-single.php?ID=92375>

⁹² Beta | 16. 08. 2016., "Petroviqi: Është e rëndësishme që Thaçi ka vizituar Gorazhdevcin" („Petrović: Značajno što je Tači došao u Goraždevac“).

normalizojmë marrëdhëniet me Serbinë, ne i japim kuptim paqes - pajtimit në mes popujve dhe vendeve tona." Me atë rast ai ka vlerësuar se nga e tërë kjo do të dalin si fitimtar.⁹³

Presidenti Hashim Thaçi, në datën 19 gusht i ka pritur kryetarët e Odave Ekonomike të Kosovës dhe të Serbisë, Safet Gërxhaliun dhe Marko Çadezhin, të cilët e kanë informuar atë mbi projektet e Odave Ekonomike të vendeve të rajonit për thellimin e bashkëpunimit midis vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kryetari i Odës Ekonomike të Serbisë Çadezh e ka informuar presidentin Thaçi mbi punën e Forumit për Investime të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor dhe mënyrën se si ato mund t'i kontribuojnë "Procesit të Berlinit" me anë të projekteve të bashkëpunimit rajonal. " Kemi bërë bashkë ekspertë të ndryshëm që të japin zgjidhje për problemet e ndryshme praktike, siç është telekomunikimi, shërbimet postare ", ka deklaruar Çadezhi, i cili ka shtuar se po punon në unifikimin e certifikatave për prodhimet e vendeve të Ballkanit Perëndimor, me qëllim që të lehtësohet transporti i mallrave. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës Gërxhaliu ia ka përcjellë presidentit Thaçi se në themelin e kësaj nisme është përpjekja që me anë të dialogut të hiqen barrierat e bashkëpunimit midis ekonomive të Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë. "Kështu do të përmirësohet edhe reputacioni i Kosovës si dhe i tërë rajonit, duke i bërë vendet tona më atraktive për investitorët e huaj", ka thënë Gërxhaliu, duke theksuar se si kompanitë e mëdha ndërkombëtare tërë rajonin e shohin si një treg unik. Presidenti Thaçi e ka përsëritur punën e odave ekonomike dhe ka deklaruar se "Është koha për një faqe të re në bashkëpunimin e tërë rajonit ", ka theksuar presidenti Thaçi. "Gjithmonë do ta keni përkrahjen tonë për projektet tuaja, të cilat e nxisin bashkëpunimin ", ka thënë presidenti Thaçi, duke përfunduar se si tashmë "i kemi kaluar shumë sfida, por më e rëndësishmja është që të mos ndalemi".⁹⁴

Në datën 28 gusht të vitit 2016, presidenti Thaçi i ka gjykuar skenat, të cilat në të njëjtën ditë kanë mundur të shihen në fshatin Mushitishtë (Mušutište) dhe ka bërë thirrje që të respektohen drejtat e të gjithëve për t'u kthyer në pronat e veta. " Janë krejtësisht të panevojshme dhe të papranueshme skenat nga fshati Mushtisht ", ka deklaruar presidenti Thaçi, i cili ka shtuar se " këto veprime nuk janë as në interes të Kosovës dhe të qytetarëve të saj ". E ka përsëritur se është e drejtë e të gjithëve për t'u kthyer në pronat e veta dhe në vendin e prejardhjes. " Çështja e të zhdukurve, e të zhvendosurve, e pronave të uzurpuara janë plagë të hapura nga lufta. Duhet t'i mbyllim sa më parë këto plagë dhe të kthehemi nga e ardhmja ", ka thënë presidenti Thaçi, dhe ka theksuar se si e ardhmja është në paqen, në dialogun dhe në bashkëpunimin reciprok. Duke shtuar se nuk ka vend për dhunën në Kosovën e re, presidenti Thaçi ka përfunduar se gjyqësori do të merret me të gjithë ata, të cilët kanë kryer krime në të kaluarën, duke qenë se " drejtësia është kusht për pajtim të sinqertë dhe për ndërtimin e Kosovës multietnike ".⁹⁵

⁹³ Fjalimi i plotë i Thaçit në përurimin e rrugës Joe Biden, Gazeta Express, 17.08.2016:

<http://www.gazetaexpress.com/lajme/fjalimi-i-plote-i-thacit-ne-perurimin-e-rruges-beau-biden-240903/>

⁹⁴ Odat Ekonomike të Kosovës e Serbisë: Të ndërtohet autostrada Prishtinë-Nish, Lajmi.net, 20.08.2016:

<http://lajmi.net/odat-ekonomike-te-kosoves-e-serbise-te-ndertohet-autostrada-prishtine-nish/>

⁹⁵ Thaçi i quan të papranueshme skenat në Mushtisht, fion të respektohet e drejta për kthim, Koha.net, 28.08.2016: <http://koha.net/?id=27&l=130172>

Këto deklarata Thaçi i ka dhënë pasi që disa qindra shqiptarë nuk i kanë lejuar serbët që të luten në kishë dhe që t'i vizitojnë pronat e tyre në Mushitishtë. Shqiptarët janë barrikaduar në rrugë, duke e penguar autobusin me serbë për të vazhduar rrugën drejt fshatit.

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Personave të Pagjetur, 31 gusht, presidenti Thaçi ka vënë në spikamë se personat e pagjetur mbasin një nga plagët më të rënda, të cilat i ka lënë lufta në Kosovë, derisa zgjidhja e fatit të personave të pagjetur është një nga detyrat më urgjente dhe më të rëndësishme për të gjithë. "Lufta ka lënë shumë plagë, por plaga e cila ka mbetur pas personave të pagjetur është një prej plagëve më serioze", ka thënë presidenti Thaçi dhe e ka tërhequr vërejtjen se kjo çështje "rëndon familjet e të pagjeturve por edhe tërë shoqërinë, marrëdhëniet mes komuniteteve por edhe gjasat për një të ardhme më të mirë". "Është nevojë urgjente, detyrë humanitare, obligim i të gjithëve që sa më parë të zbardhet fati i të gjithë të pagjeturve, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike", ka thënë presidenti Thaçi. Ai ka theksuar se si nuk kalon as edhe një ditë e që të mos i kujtojmë personat e pagjetur. "Na shikojnë nga fotot e varura në rrethojën e Kuvendit të Kosovës. Na thërrasin familjet. Na i kujtojnë memorialët që i shohim rrugëve të Kosovës. Ndërkaq, në ditët si 30 gushti, zotohemi që gjithmonë, pandërprerë, do të kërkojmë dhe do të këmbëngulim që sa më parë të zbardhet fati i secilit qytetar të Kosovës, në mënyrë që familjet e të pagjeturve të gjejnë paqen e tyre". Presidenti Thaçi ka përfunduar se "janë mu këto dhimbje që i ka shkaktuar lufta motivi ynë që të punojmë që të mos lejojmë që të përsëritet lufta por gjithmonë të ketë paqe, pajtim dhe bashkëpunim mes të gjitha komuniteteve".⁹⁶

Presidenti Thaçi e ka gjykuar profanizimin e pllakës përkujtimore në Stara Gracka, ku më herët kishte vendosur kurora. „Është për gjykim profanizimi i pllakës përkujtimore në Grackë“, ka deklaruar presidenti Thaçi dhe ka shtuar se "secili që ia do të mirën Kosovës këtë akt e dënon si të papranueshëm". Ai ka thënë se incidentet siç është ky i rrezikojnë marrëdhëniet e mira ndëretnike, çfarë i nxit Kosova, se e shkaktojnë frikën, emocionet e rënda dhe urrejtjen, për çka askush në Kosovë nuk ka nevojë. "Duke promovuar dialogun, pajtimin, bashkëpunimin, luftimin e çdo ekstremizmi, jemi pranuar si pjesë e bashkësisë ndërkombëtare. Vetëm duke i promovuar këto vlera e ruajmë vendin që e meritojmë në bashkësinë ndërkombëtare", ka shtuar presidenti Thaçi. Ai ka theksuar se si Kosova nuk mundet për të lejuar që të vuajë për shkak të një pakice ekstreme. "Në mesin e qytetarëve të Kosovës, shumica dërmuese është, nga të gjitha bashkësitë, për paqen, për qëndrueshmërinë, për zhvillimin, për një jetë më të mirë për të gjithë. Vetëm një pakicë fare e vogël edhe më tutje kultivon ide ekstremiste dhe politikën e përjashtimit, të frikës dhe të urrejtjes. Nuk do të lejojmë që kjo pakicë të rrezikojë ambiciet dhe synimet e shumicës në Kosovë", ka përfunduar presidenti Thaçi.⁹⁷

⁹⁶ Presidenti Thaçi: Të pagjeturit, plaga më e rëndë që na la lufta, Koha.net, 29.08.2016: <http://koha.net/?id=27&l=130247>

⁹⁷ Thaçi: Kosova nuk mund të lejohet të pësojë për shkak të një pakice ekstremiste, Indeksonline, 03.09.2016: <http://indiksonline.net/lajmet/thaci-kosova-nuk-mund-te-lejohet-te-pesoje-per-shkak-te-nje-pakice-ekstremiste-14195/>

Siç është thënë edhe në fillim të analizës, liderët më të lartë shtetëror dhe politik të Kosovës, me qëndrimet e tyre të publikuara nëpër media e dërgojnë mesazhin e përkushtimit ndaj pajtimit dhe bashkëpunimit, në momentin e llojeve të ndryshme të tensioneve, të cilat ekzistojnë, si në mes të bashkësive etnike në vet Kosovën, ashtu edhe në relacionet Prishtinë - Beograd. Duke pasur parasysh se, nga njëra anë, procesi i pajtimit në Kosovë, për nga natyra e tij, nuk është i lehtë, i shpejt dhe i thjeshtë, dhe se, nga ana tjetër, jep rezultate graduale, është objektive për të shprehur se ky proces kompleks, por pozitiv, do të vazhdojë edhe më tutje.

Epilogu

Pas një shtatorit, kur formalisht ka përfunduar kjo analizë, ka pasur edhe disa ngjarje, të rëndësishme në perspektivë deri në fund të vitit 2016 për proceset e bashkëpunimit dhe të pajtimit rajonal. E para, në Kroaci janë mbajtur zgjedhjet e parakohshme parlamentare, në të cilat më së shumti vota ka marrë HDZ, parti me orientim të djathtë, por me kryetar të ri Andrej Plenkovićin, politikan me qëndrime të matura.⁹⁸ Ka gjasa shumë të mëdha se nga qeveria e re me Plenkovićin si kryeministër mund të priten tone të drejtpeshuara të politikës zyrtare kroate, kur është fjala për bashkëpunimin dhe pajtimin rajonal. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, përkatësisht në Republika Srpska është mbajtur referendumi mbi Ditën e Republika Srpska si dhe zgjedhjet lokale: situata e re deri diku ka shqetësuar shpirtrat politik, por është e qartë se marrëdhëniet e brendshme politike si dhe lidhjet me fqinjët – në masën e dialogut të arsyeshëm, të bashkëpunimit dhe të pajtimit – do të mbesin ashtu siç kanë qenë edhe më parë. Ose, siç thotë profesori i të drejtës kushtetuese në Sarajevë, Kasim Trnka, „në praktikën aktuale të politikës ditore, i ashtuquajtur i referendumi nuk do të shkaktojë kurrfarë ndryshime të veçanta“.⁹⁹ Në Kosovë, ku marrëdhëniet e bashkëpunimit rajonal janë komplekse posaçërisht në lidhje me implementimin e Marrëveshjes së Brukselit, në fund të muajit shtator ka qenë e mundshme që të ndjehet tensioni pas komunikatës së Ministrit të Punëve të Jashtme të Kosovës se do ta „parandalojnë qëllimin e drejtorit të Zyrës për Kosovën dhe Metohinë Marko Gjuriqit për të qëndruar në Kosovë përkundër ndalesës së qëndrimit prej dy javësh për shkak të deklaratave të tij të pamatura.“¹⁰⁰ Megjithatë, duke marrë parasysh se marrëdhëniet ndërnacionale në Kosovë janë një proces i gjatë, i cili ka filluar për të dhënë rezultate të caktuara, ia vlen të shpresohet se ky proces plotësisht do të lëviz në frymën e pajtimit dhe të bashkëpunimit rajonal. Në Mal të Zi janë mbajtur zgjedhjet parlamentare, në të cilën ka fituar Partia Demokratike e Socialistëve (PDS) e Mile Gjukanovićit, e cila nuk e ka krijuar shumicën absolute dhe, së këndejmi, për formimin e qeverisë ka qenë e nevojshme edhe mbështetja e partive të pakicave kombëtare. Burgosja e „një grupi të gjerë të qytetarëve serb“¹⁰¹ në ditën e zgjedhjeve, me akuzën se kanë dashur për ta penguar procesin zgjedhor dhe për të kryer një lloj të grushtit të shtetit, jo vetëm që i ka ashpërsuar marrëdhëniet midis grupeve të ndryshme politike në Mal të Zi, por i ka vënë në sprovë edhe marrëdhëniet zyrtare të Podgoricës dhe Beogradit. Në fund, në Maqedoni, pas fazës shumë mujore të paqëndrueshmërisë politike, për shkak të marrëdhënieve të

⁹⁸ <http://www.telegram.hr/>, 31. 7. 2016.

⁹⁹ <http://bosnjaci.net/>, 27. 9. 2016.

¹⁰⁰ <http://rs.n1info.com/>, 22. 9. 2016.

¹⁰¹ N1 16.10.2016.

prishura të partisë në pushtet (VMRO DPMNE) dhe opozitës, janë caktuar për muajin dhjetor zgjedhjet e jashtëzakonshme, të cilat do të duhej të rezultinin me stabilitetin, si të marrëdhënieve politike, ashtu edhe të atyre ndërnacionale të maqedonasve dhe të shqiptarëve. Sipas fjalëve të Johanës Hanit, Komisarit Evropian për zgjerim, „zgjedhjet e organizuara dhe të realizuara mirë janë themel i rrugës maqedonase drejt integriteteve euroatlantike“. Këtë deklaratë Hani e ka dhënë pas takimit me kryeministrin Emil Dimitriev dhe liderët e partive në pushtet dhe të opozitës të maqedonasve dhe të shqiptarëve në Shkup. Ai ka theksuar se është po aq e rëndësishme edhe që Maqedonia të zbatojë reformat urgjente të parapara me raportin mbi prioritetet reformuese, të cilat i ka vendosur grupi i ekspertëve të BE-së si dhe që të përmbush obligimet ndaj marrëveshjes së partive politike maqedonase në Przhinë mbi zgjidhjen e krizës politike në Maqedoni, e cila është duke zgjatur tashmë e dy vite e gjysmë.¹⁰²

Bojan Munjin, kritik i teatrit dhe gazetar,
(hulumtimin për Kosovën e ka bërë Teuta Hoxha)

¹⁰² 14.10.2016. *Beta*